



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 60 regjistër (JR)  
Datë 20.10.2021

Nr. 54 i vendimit  
Datë 05.11.2024

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

|                        |                  |
|------------------------|------------------|
| <b>Natasha Mulaj</b>   | <b>Kryesuese</b> |
| <b>Rezarta Schuetz</b> | <b>Relatore</b>  |
| <b>Sokol Çomo</b>      | <b>Anëtar</b>    |
| <b>Ina Rama</b>        | <b>Anëtare</b>   |
| <b>Albana Shtylla</b>  | <b>Anëtare</b>   |

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 05.11.2024, ditën e martë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Durim Hasa, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 399, datë 14.06.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Durim Hasa.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pikat 2, 3 dhe 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenet A, C, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenet 62, 63, 65 dhe 66, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe parashtrimet me shkrim, i cili përfundimisht kërkoi konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Durim Hasa (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ai ka plotësuar dhe ka dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
2. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit të kryer për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe (c) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) prej të cilave rezultoi si më poshtë.
3. ILDKPKI-ja, ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, me nr. {\*\*\*} prot., datë 08.11.2019, duke konstatuar se: *1. Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; 2. Ka mungesë të dokumentacionit ligjor për të justifikuar pasuritë; 3. Ka mosdeklarime të pasurisë; 4. Nuk ka kryer deklarim të rremë; 5. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>1</sup> nr. {\*\*\*} prot., datë 08.02.2021, për subjektin e rivlerësimit, tek i cili ka konkluduar mbi *papërshtatshmërinë* për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Durim Hasa.

---

<sup>1</sup> Deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.03.2021.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGG”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të për zgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.
6. Komisioni, në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, ka përfunduar hetimin administrativ bazuar në tri kriteret e vlerësimit, në provat e administruara dhe e njohu subjektin e rivlerësimit me rezultatet e hetimit kryesisht, duke i kërkuar të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Pasi e dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, Komisioni mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura dhe vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit me vendimin nr. 399, datë 14.06.2021. Në përfundim, bazuar në kriterin e pasurisë dhe vlerësimin tërësor, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin *të pasaktë* dhe *të pamjaftueshëm* për kriterin e kontrollit të pasurisë, si dhe ka *cenuar besimin* e publikut të sistemi i drejtësisë, sipas parashikimeve në pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

## **II. Mbi ankimin dhe shkaqet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit**

7. Më datë 14.10.2021, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë ankim kundër vendimit të Komisionit brenda afatit ligjor. Në përfundim të ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji ndryshimin e vendimit nr. 399, datë 14.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë. Shkaqet e ankimit të subjektit paraqiten në mënyrë të përmbledhur në vijim.

### *A. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale*

7.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është paravendosur, i pabazuar në prova dhe analizë të saktë financiare, si dhe ka mungesë argumentimi e analize juridike të gjetjeve dhe rrethanave konkrete. Për këto arsye, Komisioni ka shkelur garancitë e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”). Si pasojë, vendimi është marrë në cenim të procesit të rregullt ligjor, si dhe në shkelje të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016.

### *B. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë*

7.2. Shumën prej 200.000 lekësh, krijuar pas ndërprerjes së punës në arsim dhe largimit nga familja bujqësore, subjekti i rivlerësimit pretendon se ia dhanë prindërit dhe vëllezërit në mesin e vitit 1994, për kontributin që kishte dhënë në familje. Këto të ardhura nuk mund t'i provojë, pasi ishte një aktivitet informal, të cilin vëllai i tij vazhdon ende ta ushtrojë.

7.3. Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 96,6 m<sup>2</sup>, ndodhur në Linzë, Tiranë, subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit për deklarimin periodik të vitit 2006, për sa i përket mospërputhjes së shumës së deklaruar si pakësim i gjendjes *cash* në vlerën 3.800.000 lekë, me vlerën e shlyer prej 34.000 eurosh, për këtë pasuri. Sipas subjektit, Komisioni ka kryer një gabim në përllogaritjet në deklarimin e kursimeve të vitit 2006. Si burim i të ardhurave të dhëna hua nga vëllai i subjektit dhe dhurimi nga i ati, përkatësisht prej

400.000 lekësh dhe 1.000.000 lekësh, kanë shërbyer të ardhurat nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral që ata kanë ushtruar së bashku, të cilat i kanë ndarë mes tyre çdo vit.

7.4. *Lidhur me huan e dhënë nga z. S. L. dhe interesat nga huaja*, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka gabuar që nuk i ka konsideruar të ardhurat nga ky transaksion, pasi kontrata nuk ka pasur shkaqe pavlefshmërie. Subjekti pretendon se është penalizuar nga Komisioni, për një vendim të dhënë ndaj z. L., për të cilin nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, sepse marrëdhënia e huasë me këtë individ kishte përfunduar 9 vite përpara se ai të jepte një vendim, i cili sipas subjektit ka qenë i drejtë.

7.5. *Për sa i përket blerjes së shtëpisë në lagjen “{\*\*\*}”, Çorovodë*, subjekti i rivlerësimit pretendon, në ankim, se pas shpjegimeve të subjektit, Komisioni e ka zbritur bilancin negativ në shumën prej (-) 375.482 lekësh, nëse në analizë do të përfshihej edhe shuma prej 200.000 lekësh e dhënë atij nga familja në vitin 1994, referuar më sipër, diferenca negative do të ulej në (-) 175.482 lekë. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se veprimet e shitblerjes në vitin 1996 përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës së Magjistratit, duke kërkuar nga Kolegji që rastin ta vlerësojë në kushtet e kohës kur janë kryer veprimet. Ai sqaron se banesën 1+1 në lagjen “{\*\*\*}”, Çorovodë, e ka blerë pa dokumente nga shitësi [z. E. D.], veprim që e ka kryer kur kishte përvojë më pak se dy vite si gjyqtar. Nëse do të duhet ta kryente “në ditët e sotme” do ta “mendonte mirë”.

7.6. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se shpjegimet e tij kanë qenë të pamjaftueshme në lidhje me mënyrën e blerjes së apartamentit me sip. 55 m<sup>2</sup> në lagjen “{\*\*\*}”, Berat dhe përlllogaritjen e shumës 550.000 lekë, të paguar në “Alpha Bank” si shpenzim. Ai pretendon se ka depozituar në bankë shumën prej 1.250.000 lekësh, nga të cilat vetëm 700.000 lekë ishin të tij. Pjesa tjetër prej 550.000 lekësh ishte e shitësve të apartamentit. Subjekti pretendon se kjo dinamikë kishte për qëllim evitimin e veprimeve të tepërta bankare.

7.7. *Lidhur me të ardhurat nga qiraja e njësisë në shumën 1.140.000 lekë për periudhën 15.12.2011 – 30.09.2015*, subjekti i rivlerësimit pretendon se pagesa e tatimeve nuk ishte detyrimi i tij. Komisioni nuk e ka konsideruar shumën të ligjshme, ndonëse subjekti ka paraqitur provën e pagesës së tatimit.

7.8. *Të ardhurat e djalit të tij [z. O. H.]*, në vitet 2014 dhe 2015, në vlerën 540.000 lekë, janë nga puna informale. Subjekti sqaroi se i ka deklaruar këto të ardhura në deklaratat e pasurisë, sepse i ka konsideruar si të ardhura që kanë hyrë në ekonominë familjare. Detyrimi për pagesën e kontributeve ka qenë i punëdhënësit, dhe jo i djalit të tij.

7.9. *Të ardhurat prej 800.000 lekësh*, të përfituara nga shitja e artikujve të ndryshëm ushqimorë që i përkisnin biznesit të mbyllur të bashkëshortes së tij, nuk janë deklaruar gabimisht në deklaratën periodike të vitit 2011. Kjo shumë provohet nga kontrata e qirasë e nënshkruar me znj. T. Ç., sipas së cilës qiramarrësi ka blerë edhe mjetet e xhiros në shumën prej 800.000 lekësh.

#### *C. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës*

7.10. Subjekti i rivlerësimit pretendon se informacioni i përcjellë në raportin e DSIK-së nuk plotëson asnjë nga kriteret ligjore të përcaktuara në nenin DH, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të

Kushtetutës, sikurse as nuk përmban asnjë nga elementet e parashikuara nga neni 38, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016. Ky informacion nuk është mbështetur në asnjë verifikim, nuk bazohet në asnjë provë. Si i tillë, ai duhet të konsiderohet i paplotë dhe i pavlerë për kontrollin e figurës. Po ashtu, subjekti konteston në mënyrë specifike tri çështje, duke pretenduar se:

- i) për çështjen gjyqësore që i përket B. I., *zëvendësimi* i masës së sigurimit nga *arrest në burg* në *detyrim paraqitjeje* u vendos pasi nevoja e sigurimit ishte zbutur e, për rrjedhojë, masa e mëparshme nuk ishte më masa e vetme e përshtatshme për rastin konkret;
- ii) për procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë 25.09.2018, të Prokurorisë për Krimet e Rënda, është njohur në raportin për rezultatet e hetimit të Komisionit. Nuk ka pasur informacion më parë;
- iii) në çështjen gjyqësore që i përket A. M., ka takuar xhaxhanë e të pandehurit në rrethana të rastësishme, pa e ditur lidhjen familjare të të pandehurit me personin që ka takuar. Gjatë atij takimi nuk ka pasur përpjekje për ndikim të paligjshëm.

#### *D. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin tërësor*

7.11. *Lidhur me çështjen gjyqësore me kërkues A. Z.*, vendimi për konstatimin për të rehabilituar kërkuesin është i drejtë, i bazuar në ligj dhe i arsyetuar. Instituti i rehabilitimit nuk e ndalon rehabilitimin e të dënuarve që përfundojnë vuajtjen e dënimit, pavarësisht sa herë janë dënuar ata. Subjekti argumenton se kufizimi i vetëm i nenit 69, germa “b” e Kodit Penal është që i dënuari gjatë periudhës prej pesë vitesh nga vuajtja e dënimit të mos kryejë vepër tjetër penale dhe jo të mos dënohet për një vepër penale të kryer përpara kësaj periudhe.

### **III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

#### **A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegji**

##### *i. Juridiksioni i Kolegjit*

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin dhe shkarkimin nga detyra të subjekti rivlerësimi, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Shqyrtimi i ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit kryhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### *ii. Legjitimimi i ankuesit*

9. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, ankimi është depozituar brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016

*iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

10. Në përputhje me nenin 65, pika 1<sup>2</sup> e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë dorëzuar me ankimin akte për administrimin e tyre nga Kolegj në cilësinë e provës. Në datën 22.10.2024, subjekti i rivlerësimit ka depozituar parashtrime në lidhje me ankimin kundër vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit. Këto parashtrime nuk shoqërohen me akte. Në të dy këto momente procedurale, subjekti kërkon ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë. Për rrjedhojë, çështja objekt gjykimi, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

***B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për shkaqet e ankimit***

***A. Shkaqet procedurale dhe ato që lidhen me interpretimi e ligjit***

11. Subjekti i rivlerësimit kundërshton vendimin e Komisionit, duke pretenduar se ai është në shkelje të procesit të rregullt. Në mënyrë të përmblëdhur, argumentet e parashtruara për këtë aspekt janë që: (i) vendimi i Komisionit është paragjykuar, i pabazuar në prova e në analizë të saktë financiare, i pabazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 17, 30, 31, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë argumentimi dhe analize juridike të gjetjeve dhe rrethanave konkrete; (ii) vendimi është kontradiktor në vetvete, për sa i përket kriterëve të figurës dhe atij profesional, pasi arsyetimi e konkluzioni bien ndesh me njëri-tjetrin; (iii) për kriterin e vlerësimit të pasurisë, shkeljet nuk janë të atilla që të passjellin shkarkimin nga detyra. Subjekti nuk gjendet në asnjë nga kushtet e parashikuara nga pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi sjellja në kuadrin e deklaramit të pamjaftueshëm ose të pasaktë duhet të ketë “të njëjtin nivel kundërligjshmërie”, sikurse janë rastet e renditura në pikat 1, 2, 4 dhe 5 të këtij neni. Kushtetuta nuk synon të largojë nga sistemi i drejtësisë personat që mund të kenë pasaktësi në deklaramet e tyre, për të cilët nuk ka indicie për përfshirjen në veprimtari të paligjshme apo të papajtueshme me detyrën; (iv) vendimi është marrë në cenim të procesit të rregullt ligjor dhe në shkelje të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka mbajtur standarde të ndryshme për qëllim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës në vendime të ndryshme, duke shkelur parimin e barazisë para ligjit për subjektet e rivlerësimit. Komisioni ka shkelur garancitë e nenit 6 të KEDNj-së.

11.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit nuk specifikojnë veprime konkrete nëpërmjet të cilave ai ka deduktuar paragjykimin e Komisionit. Po ashtu, dispozitat ligjore, që referuar subjektit janë shkelur, rregullojnë disa parime kryesore për vlerësimin e kriterit pasuror [nenet 30-33], duke nënkuptuar në këtë mënyrë që ankimi, edhe për këtë aspekt, në thelb kundërshton konkluzionin për pasurinë dhe jo probleme të procesit të rregullt. Nga ana tjetër, neni 17 i ligjit nr. 84/2016, rregullon procesin disiplinor për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit. Në

---

<sup>2</sup> “[...] Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

kushtet që kjo dispozitë nuk ka asnjë relevancë me mënyrën sesi kryhet një proces rivlerësimi për një subjekt rivlerësimi, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, që procesi konkret nuk rezulton të ketë pikëprerjeje me ndonjë proces disiplinor të zhvilluar për ndonjë prej anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, ndërsa subjekti nuk ka dhënë rrethana konkrete për të cilat do të duhet të kryhej analizë, trupi gjykues i Kolegjit prezumon se neni 17 i ligjit duhet të jetë një gabim material.

**11.2.** Në vijim, për sa rezulton nga aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se procesi i hetimit administrativ dhe në pikën fundore, zgjidhja e çështjes nga Komisioni, rezultojnë të jenë rezultat i arritur në një proces të rregullt ligjor. Komisioni nuk rezulton të ketë treguar paragjykim në ndërveprimet me subjektin apo që çështja të ketë qenë e paravendosur. Komisioni e ka njohur subjektin e rivlerësimit me përfundimin e rezultateve të hetimit më 19.03.2021, dhe e ftoi atë të njihet me aktet e dosjes. Në datën 24.03.2021, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar kohë shtesë për të paraqitur shpjegimet dhe provat, për të përmbysur barrën e provës së kaluar me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht. Kjo kërkesë u pranua nga Komisioni dhe afati u shty deri në datën 12.04.2021. Në datën 28.05.2021, Komisioni përfundoi hetimin kryesisht për dy kriteret e tjera, duke i kaluar subjektit barrën e provës për gjetjet, si dhe e njoftoi për mundësinë që me shpjegimet dhe provat subjektit të provojë të kundërtën e barrës së provës, duke i dhënë afat deri në datën 04.06.2021. Subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e tij në seancën dëgjimore të datës 11.06.2021, duke parashtruar prapësime lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, mbi kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

**11.3.** Po ashtu, subjekti nuk rezulton të ketë pretenduar apo argumentuar as në Komision veprime të trupit gjykues që sipas tij kanë treguar paragjykim, dhe as të ketë pasur kërkesa procedurale për të cilat Komisioni i ka mohuar mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tij apo që i ka anashkaluar e trajtuar pa i kushtuar vëmendje. Nga secili këndvështrim, rezulton që subjektit t'i jenë respektuar të gjitha garancitë procedurale në hetimin administrativ, përfshirë të drejtën e njohjes me aktet e administruara gjatë hetimit paraprak, mundësinë e mbrojtjes, të drejtën për t'u dëgjuar, sjellë prova e shpjegime dhe një kohë e arsyeshme për përgatitjen e tyre. Po ashtu, dhe në kushtet që subjekti nuk shprehet për pasjen e ndonjë prej cilësive të mbrojtura shprehimisht nga detyrimet ligjore e konventore<sup>3</sup>, pretendimi i subjektit për paragjykim nga Komisioni mbetet i paargumentuar e i pabazuar. Për secilën çështje, Komisioni ka analizuar faktet dhe provat që janë paraqitur gjatë procesit e që janë administruar në gjykim, si dhe ka argumentuar qëndrimin e mbajtur në përfundim të vlerësimit.

**11.4.** Nga ana tjetër, pretendimi se vendimi i Komisionit është i paarsyetuar dhe në shkelje të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, rezulton, po ashtu, i pabazuar. Nga analiza e vendimit të Komisionit kundrejt përcaktimeve të nenit 57 të ligjit nr. 894/2106 konstatohet qartë se teksti përmban të gjitha elementet e përcaktuara nga kjo dispozitë në pikat 2 deri në 5 të saj. Konkretisht, duke ndjekur edhe rrjedhën e normës, vendimi përmban: pjesën hyrëse – emërtimin zyrtar të Komisionit, trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen dhe punonjësin administrativ, orën dhe vendin e vendimit të dhënë, emrin dhe identitetin e subjektit të rivlerësimit, mendimin e subjektit të rivlerësimit; elementet e pjesës përshkruese-arsyetuese – rrethanat e çështjes të vlerësuar dhe përfundimet e

---

<sup>3</sup> Referuar nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 14 të KEDNj-së.

nxjerra për secilën prej tyre nga trupi gjykues, provat e analizuar dhe arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi, njohjen nga trupa gjykuese e raportit dhe rekomandimit të relatores, dispozitat ligjore në të cilat mbështetet shqyrtimi i kriterëve dhe vendimmarrja; dhe së fundmi, elementet e pjesës urdhëruese – masën disiplinore të vendosur, të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij.

**11.5.** Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit, për shkaqet e ankimit që lidhen me analizën financiare, trajtohet në vijim, në vlerësimin e dedikuar këtij shkaku ankimi. Në këtë rubrikë të vendimit, në planin ligjor, vlen të theksojmë vetëm që në kontrollin e pasurisë për efekt të rivlerësimit, Komisioni e Kolegji nuk kryejnë një kontroll me tipare kontabiliteti të thjeshtë. Kontrolli i pasurisë në rivlerësim përbën në thelb zbatimin e parimeve të ligjit në drejtim të besueshmërisë së subjektit në kriterin e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, me fokus ligjshmërinë e burimeve të krijimit të tyre dhe të përmbushjes së detyrimeve financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Kjo nënkupton që Komisioni merr vendimin pasi kryen një hetim administrativ shterues dhe kundërshtimet/prapësimet e subjektit për analizën financiare duhet të mbështeten në prova dhe i nënshtrohen edhe kontrollit të Kolegjit, në pikën fundore nëse ka ankim. Sikurse konstatohet në vijim, edhe ky shkak ankimi, bazohet në konkluzionin e Komisionit për zgjidhjen e çështjes e merr përgjigje të detajuar në vijim.

**11.6.** Edhe pretendimi për zbatim standardesh të ndryshme, krahasuar me subjekte të tjerë, vlerësohet i pabazuar. Barazia para ligjit, sikurse elaboruar edhe nga Gjykata Kushtetuese<sup>4</sup>, nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia në ligj dhe para ligjit presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Ky interpretim buron nga vetë natyra e parimit të barazisë përpara ligjit, të sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës, që nënkupton të drejtën për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë, duke u mbrojtur nga diskriminime të pambështetura në një përligjje të arsyeshme dhe objektive. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se ky pretendim është artikuluar në mënyrë sipërfaqësore, pasi në ankim subjekti nuk ka argumentuar apo identifikuar situata të ngjashme faktike me të, për të cilat Komisioni ka konkluduar ndryshe. Megjithatë, në çdo rast, një pretendim i tillë i subjekteve të rivlerësimit nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

## **B. Vlerësimi i kriterit të pasurisë**

12. Konkluzioni i Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë bazohet në problematikat e rezultuara nga kontrolli i burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e tre pasurive të paluajtshme, një huadhënieje dhe nga balanca negative e analizës financiare për disa vite të periudhës së rivlerësimit. Përfundimisht, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm, parashikuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, në ndërthurje me

---

<sup>4</sup> Shih vendimin nr. 11, datë 27.08.1993, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.



parashikimet e germave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të të njëjtit ligj. Subjekti ka ngritur shkaqe ankimi për aspekte përcaktuese të kontrollit të pasurisë, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit për secilin prej tyre. Në analizën përfundimtare të kryer, edhe pas korrektimeve, subjekti rezultoi me një balancë negative për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, në vlerën (-) 4.743.825 lekë. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit u konfirmua edhe në Kolegj pas kontrollit të ushtruar bazuar në shkaqet e ankimit. Në vijim arsyetimi për secilin shkak të ankimit, grupuar sipas efektit mbi pasuritë.

### **B.1. Apartament me sipërfaqe 96,6 m<sup>2</sup> në Tiranë**

13. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* se zotëron një apartament me sipërfaqe 96,6 m<sup>2</sup> në Linzë, Tiranë, të cilin e ka blerë më 10.09.2007<sup>5</sup>, në vlerën prej 29.000 eurosh, me burim të *ardhurat e familjes*. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë të burimeve të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *vetting*, krahasuar me atë periodike vjetore, dhe gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e saj, pasi ka rezultuar me një balancë negative prej (-) 2.255.902 lekësh për të justifikuar shumën prej 34.000 eurosh, të shlyer në vitin 2006 me kontratën e sipërmarrjes së hartuar për këtë pasuri. Për këto arsye, subjekti gjendet në kundërshtim me parashikimin e germës “a” dhe në kushtet e germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në analizën financiare në funksion të krijimit të kësaj pasurie nuk u përfshi një shumë prej 200.000 lekësh, që subjekti pretendoi ta ketë disponuar në vitin 1992, nga punësimi i mëparshëm. Analiza financiare negative, po ashtu, u afektua nga një mungesë burimesh në vitin 2005, për shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, kursimet e deklaruara në vitin 2006, si dhe një dhurim i pretenduar nga i ati e një huaje nga vëllai i subjektit, përkatësisht në vlerat 1.000.000 dhe 400.000 lekë.

13.1. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, si dhe për mospërputhjen në burimet e deklaruara. Konkretisht, subjekti pretendon se familja e origjinës [prindërit dhe vëllezërit] i dhanë 200.000 lekë në mesin e vitit 1994, pas largimit nga familja bujqësore, për kontributin që kishte dhënë në familje, të cilat nuk mund t’i provojë, pasi ka qenë aktivitet informal. Konkluzioni i Komisionit se këto të ardhura nuk mund të merren në konsideratë, për shkak të inflacionit që ka pasur ekonomia shqiptare në ato vite, është i gabuar. Në atë periudhë, sipas subjektit, pati rritje të ndjeshme të çmimeve për produktet bujqësore dhe blegtorale, që gjeneruan likuiditete. Po ashtu, subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit për deklarimin periodik të vitit 2006 është i gabuar. Nuk ka mospërputhje të shumës së deklaruar si pakësim i gjendjes *cash* në vlerën 3.800.000 lekë me likuidimin e apartamentit në shumën prej 34.000 eurosh, por gabim në përlllogaritjet e kryera në deklarimin e kursimeve të vitit 2006. Babai dhe vëllai kanë pasur mundësi të kontribuojnë, pasi ata kanë ushtruar aktivitet bujqësor dhe blegtoral së bashku dhe kanë ndarë të ardhura çdo vit. Libreza e kursimeve të vëllait, që ai ka paraqitur në Komision, provon mundësinë financiare për t’i dhënë huanë subjektit. Në përfundim, subjekti i

---

<sup>5</sup> Blerë nga subjekti i rivlerësimit me kontratën e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 10.09.2007, me palë shitëse shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

rivlerësimit pretendon se nuk ka pasur pasaktësi për financimin e kësaj pasurie dhe provohet se apartamenti është krijuar me burime financiare të ligjshme.

13.2. Nga analiza e pretendimeve të subjektit dhe akteve në fashikull nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *vetting*. Ndërsa në deklaratën për vitin 2006, subjekti pasqyron huan marrë të vëllait dhe dhurimin e prindërve, që gjatë hetimit i ka atribuuar si burim krijimi i vlerës së përdorur për shlyerjen e pasurisë, këto aspekte nuk gjejnë pasqyrim në deklaratën *vetting* e as është shpjeguar mospërputhja me rezultatet e hetimit. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka pretenduar dhurimin nga i ati si kontribut në momentin e bashkimit të dy familjeve në vitin 2006. Në kushtet që mospërputhjet në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë nuk janë kontestuar, trupi gjykues i Kolegjit e konsideron të konfirmuar këtë gjetje të Komisionit. Subjekti ka qenë jokonsistent në deklarimin e vlerës së apartamentit dhe sipërfaqes së tij. Në deklaratën *vetting*, apartamenti është deklaruar në vlerën 29.106 euro dhe sipërfaqja si më sipër, ndërsa në deklaratën periodike për vitin 2006, çmimi është referuar 46.500 euro dhe sipërfaqja 103 m<sup>2</sup>.

13.3. Subjekti ka prapësuar barrën e provës dhe ngritur shkaqe ankimi vetëm për burimet e krijimit të pasurisë. Për rrjedhojë, analiza e trupit gjykues të Kolegjit në vijim fokusohet në *mjaftueshmërinë* e burimeve të krijimit të totalit të vlerës së pretenduar të paguar prej 34.000 eurosh në vitin 2006 [ekuivalenti në lekë i përreth 4.200.000 lekëve, sipas kursit të këmbimit të kohës] dhe referuar deklarimit të subjektit në deklaratën periodike vjetore. Në këtë shumë përfshihet edhe blerja e një garazhi në të njëjtën ndërtesë, sikurse ka rezultuar gjatë hetimit administrativ në Komision<sup>6</sup>. Në kontrollin e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e kësaj shume, paraqet peshë përcaktuese mundësia e krijimit të shumës *cash* prej 3.800.000 lekësh, në momentin e pagimit të apartamentit në vitin 2006. Rezulton se këtë shumë Komisioni e ka përlllogaritur<sup>7</sup> si shumatorja e kursimeve të subjektit në vlerën 100.000 lekë jashtë sistemit bankar dhe një depozitë bankare prej 450.000 lekësh deri në fund të vitit 2003, kursime në vitet 2004, 2005 dhe 2006, në *cash* përkatësisht 500.000 lekë, 950.000 lekë dhe 400.000 lekë dhe kontribute të babait e vëllait të subjektit në vitin 2006, përkatësisht si dhurim, 1.000.000 lekë, huaja prej 400.000 lekësh, si dhe kursime të tjera. Komisioni konstatoi se ekuivalenti i shumës 34.000 euro është 4.205.902 lekë dhe, për rrjedhojë, rezulton një diferencë prej 405.902 lekësh e paguar gjatë vitit 2006.

13.4. Nga analiza e kryer, duke marrë në konsideratë sa më sipër, edhe në Kolegj, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për të krijuar kursimet e deklaruara deri në vitin 2003. Duke e konsideruar të bazuar qasjen e Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit thekson se shuma e pretenduar e kursyer në vitet 90' dhe dhuruar subjektit nga familja u konsiderua e paprovuar, për disa arsye. *Së pari*, subjekti ka sjellë vetëm librezat e punës të tij dhe bashkëshortes, që provojnë punësimin e tyre si mësues. Fakti që subjekti ka qenë i punësuar përpara vitit 1994, kur ai është emëruar gjyqtar, nuk është kontestuar asnjëherë, për arsyen evidente që ai në atë moment ishte 36 vjeç dhe

<sup>6</sup> Referuar në pikat 2.7 dhe 2.8 të vendimit. Subjekti rezulton të ketë blerë edhe një njësi shërbimi në të njëjtën ndërtesë.

<sup>7</sup> Referuar paragrafit 1.15 të vendimit të Komisionit.

familjar me dy fëmijë<sup>8</sup>. Për rrjedhojë, këto akte nuk janë provë e disponimit apo dhurimit nga familja të vlerës 200.000 lekë. Nga ana tjetër, për të provuar të ardhurat e familjes së origjinës nga bujqësia, subjekti ka sjellë vetëm aktin e marrjes së tokës në pronësi lëshuar në emër të të atit. Ndonëse provojnë përfitimin e tokës arë, pemëtore e truall, dokumentet në fjalë nuk përbëjnë provë për të treguar edhe indirekt dhurimin/përfitimin nga subjekti të kësaj shume monetare të *konsiderueshme* për kohën, që kapërcente edhe pagat vjetore të tij dhe bashkëshortes<sup>9</sup>. Vërtetimi (pa datë e nr. prot.) i përcjellë si provë në Komision nga subjekti, lëshuar nga kryetari i fshatit [Kapinovë, Skrapar], për të konfirmuar që vëllai i subjektit ushtron veprimtari si bujk, përfshirë edhe gjatë kohës kur kryhej hetimi administrativ për rivlerësimin, nuk përbën provë të të ardhurave të përfituara nga subjekti sipas pretendimit.

**13.5.** Trupi gjykues e gjen të drejtë arsyetimin e Komisionit, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, për të marrë në konsideratë efektin financiar të ndryshimeve politike, ekonomike e sociale të Shqipërisë në vitet 90', përfshirë zhvlerësimin e monedhës zyrtare, inflacionin deri në 400% dhe pamundësinë për të krijuar kursime të qenësishme<sup>10</sup>. Ky qëndrim tashmë është konsoliduar në vlerësimet e kryera në Kolegj për pretendime kursimesh të kësaj periudhe. Ky vlerësim mban në konsideratë edhe faktin që subjekti e ka deklaruar ekzistencën e kësaj shume për herë të parë në deklaratën *vetting*, 23 vjet pasi kishte filluar detyrën dhe 13 vjet pas deklarimit të parë të pasurisë, ndërsa logjikisht do të ishte më e pritshme që kursimi në fjalë të kishte gjetur pasqyrim më afër kohës kur dispohej dhe vlera monetare kishte një peshë financiare proporcionale shumë më të lartë, sikurse referuar më sipër si krahasim me pagat.

**13.6.** *Së dyti*, nga shqyrtimi i shkaqeve të tjera të ankimit me fokus krijimin e kësaj pasurie, edhe në analizën e kryer në Kolegj, subjekti dhe personat e *tjerë* të lidhur, i ati e vëllai, rezultuan me pamundësi financiare për të mundësuar kontributin e pretenduar me burime të ligjshme. Konstatimi i Komisionit se mundësia e prindërve për të dhuruar shumën prej 1.000.000 lekësh, me të ardhurat nga bujqësia e pensionet, konfirmohet edhe pas analizës së kryer në Kolegj. Akti i marrjes së tokës në pronësi, pa datë, sjellë si provë, tregon vetëm përfitimin e pasurive nga prindërit e familja për efekt të zbatimit të ligjit nr. 7501/1991. Edhe deklarata noteriale<sup>11</sup> e hartuar gjatë rivlerësimit nga një individ që deklaroi se ka blerë bimë medicinale nga babai i subjektit dhe aktet

<sup>8</sup> Referuar deklaratës *vetting*.

<sup>9</sup> Pagat vjetore të subjektit dhe bashkëshortes së bashku, në vitin 1994 dhe 1995 ishin nën këtë vlerë, përkatësisht 127.480 lekë dhe 188.562 lekë. Një apartament i blerë prej tij në vitin 1996 kushtoi 450.000 lekë.

<sup>10</sup> Sikurse shtjelluar gjerësisht e referuar edhe nga Komisioni në vendimin objekt ankimi, bazuar në vendimin e Kolegjit nr. 14/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit A. B..

<https://data.worldbank.org/indicator/FP.CPI.TOTL.ZG?locations=AL>, <https://www.ebrd.com/downloads/research/economics/workingpapers/wp0088.pdf> [https://www.indexmundi.com/albania/inflation\\_rate\\_\(consumer\\_prices\).html](https://www.indexmundi.com/albania/inflation_rate_(consumer_prices).html) <http://open.data.al/en/lajme/lajm/id/71/Historic-Inflation-in-Albania>, [https://www.bankofalbania.org/rc/doc/inflacioni\\_8660.pdf](https://www.bankofalbania.org/rc/doc/inflacioni_8660.pdf), faqe 18 dhe 19. <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/71/titull/HistorikiInflacionitneShqiperi/Historik-i-Inflacionit-ne-Shqipëri>.

<sup>11</sup> Deklaratë nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 19.01.2021. Deklaruesi, z. B. Sh., shprehet se ka kryer aktivitet privat në fushën e grumbullimit dhe përpunimit të bimëve medicinale pas vitit 1993 dhe që i ati i subjektit i ka shitur çdo vit bimë medicinale, duke siguruar të ardhura të konsiderueshme. Deklaruesi ka bashkëlidhur ekstrakt të QKB-së, ku ai figuron i regjistruar në datën 09.05.2012, me aktivitet në fushën e grumbullimit, përpunimit të bimëve mjekësore dhe një librezë pune e bashkëshortes së deklaruesit, sipas së cilit ajo rezultoi e punësuar pranë kësaj shoqërie, përgjatë periudhave 01.11.1999 - 31.01.2000 dhe 01.10.2001 - 30.06.2002.

bashkëlidhur nuk provojnë shumën e përfutur e as atë të deklaruar, edhe duke abstraguar nga kriteri i ligjshmërisë. Përpos faktit që kjo deklaratë është hartuar gjatë rivlerësimit, subjekti nuk arriti të provojë edhe në aspektin ekzistencial marrëdhënien e biznesit mes të atit dhe deklaruesit në asnjë formë.

13.7. Në të njëjtën linjë, për sa i përket *huas* prej 400.000 lekësh nga i vëllai në vitin 2006, deklaruar në deklaratën për vitin 2006 dhe elaboruar më tej në pyetësin standard të Komisionit, subjekti ka deklaruar se e ka shlyer atë në dy pjesë: në vitin 2007 ka shlyer 100.000 lekë dhe në vitin 2008 ka shlyer 300.000 lekë. Bashkëlidhur pyetësin standard, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë edhe një deklaratë noteriale<sup>12</sup> të hartuar nga i vëllai për shkak të kontrollit të ushtruar për subjektin nga ILDKPKI-ja në mars 2015, që kryesisht konfirmon pretendimet e tij. Për të provuar mundësinë e vëllait për të dhënë huanë, subjekti paraqiti në Komision vërtetimin nga Sektori Veterinar Berat që mban datën 05.11.2019. Sipas këtij vërtetimi, vëllai i subjektit ushtron veprimtari blegtorale në fshatin Kapinovë dhe ka regjistruar fermën në vitin 2011 në sistemin e tyre kompjuterik, ndërsa aktiviteti blegtoral ka filluar përpara këtij viti. Subjekti pretendoi edhe që vëllai i tij gëzon situatë të mirë financiare nga aktiviteti dhe ka kursime të investuara në bono thesari në Raiffeisen Bank.

13.8. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe ky pretendim gjendet i pabazuar, aktet e sjella nga subjekti nuk arrijnë të provojnë qoftë mundësinë e krijimit të shumës së dhënë hua apo rrethana të tjera edhe indirekte që do të provonin mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur/vëllait, për të kontribuar me huan në vitin 2005 ose 2006. Edhe deklarata noteriale, në kushtet që rezulton e hartuar gjatë kontrollit të ushtruar nga ILDKPKI-ja, nuk përbën gjurmë të kohës, pasi është hartuar nëntë ose dhjetë vjet pas huadhënies<sup>13</sup>. Aktet e tjera të përcjella nga subjekti, përfshirë ato që referojnë regjistrimin e aktivitetit në vitin 2011 apo ushtrimin në një kohë të papërcaktuar përpara këtij caku kohor apo ato të lëshuara nga funksionarë të pushtetit vendor, janë të përgjithshme dhe me mungesë detajesh sasiore për qëllimet e të provuarit të shumës së dhënë hua. Në të njëjtën linjë, konfermat bankare për të vëllain për vitet 2005-2009, edhe në vlerësimin e Kolegjit, nuk provojnë burimin me të cilin janë ushqyer këto llogari bankare e, për pasojë, as ligjshmërinë e tyre.

13.9. Një zë i veçantë i vendimit të Komisionit dhe i shkaqeve të ankimit është një *shumë* prej 200.000 lekësh, deklaruar si *e ardhur* në deklaratën periodike për vitin 2005 dhe në deklaratën *vetting*, si interes nga *dhënia hua* e një shume 1.200.000 lekë në vitet 2004-2005. Bashkë me deklaratën *vetting*, subjekti ka përcjellë edhe një deklaratë noteriale të vitit 2015<sup>14</sup>, si dokumentacion mbështetës. Komisioni ka konstatuar se subjekti ishte në pamundësi për të krijuar burime të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas dhe shuma e fituar nga interesat nuk përmbush kriteret e ligjshmërisë. Komisioni ka konkluduar edhe që subjekti nuk ka deklaruar saktë momentin kur e ka dhënë huan, si dhe ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit me huamarrësin. Ndërsa aspekti i konfliktit të interesit analizohet më tej në këtë arsyetim, në vlerësimin tërësor, në këtë pjesë të vendimit, shtjellohet vetëm aspekti që lidhet me kriterin e vlerësimit të pasurisë, për

<sup>12</sup> Me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 24.03.2015.

<sup>13</sup> Sipas deklaratës si më sipër, në datën 24. 03.2015, vëllai i subjektit shprehet se i ka dhënë subjektit/të vëllait huan “10 vite më parë”.

<sup>14</sup> Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 25.03.2015.

arsye kronologjike. Konkretisht, efektet financiare të huadhënies dhe interesit analizohen së bashku me burimet e ligjshme të disponuara nga subjekti në periudhën kohore kur deklarohet të jetë zhvilluar marrëdhënia 2004-2005 dhe shlyerja në vitin 2006.

**13.10.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka gabuar që nuk i ka konsideruar të ardhurat nga ky transaksion, pasi kontrata nuk “ka pasur shkaqe pavlefshmërie”. Po ashtu, pretendon se shuma e përfituar nga huadhënia, në masën 200.000 lekë, përveçse është një pjesë me ndikim minimal në bilancin financiar të vitit, nuk duhet të përdoret si arsye për vendosjen e masës disiplinore, siç është largimi nga puna. Kontrata ishte përmbushur, duke u realizuar qëllimi i palëve. Aspektet që lidhen me ushtrimin e detyrës në kushtet e konfliktit të interesit dhe analiza e trupit gjykues për shkaqet e ankimit të ngritura për to gjendet e shtjelluar në detaj [në rubrikën e vlerësimit tërësor, në paragrafin 17 e nënpjesët e tij].

**13.11.** Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të bazuar konkluzionin e Komisionit. Në kushtet që subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar pasuritë dhe përballuar shpenzimet në periudhën kohore në fjalë, edhe në Kolegj u konfirmua konstatimi i Komisionit. Nga ana tjetër, vlerat e deklaruara të përfituara nga interesi që gjeneroi kjo hua nuk u përfshinë në mesin e të ardhurave të ligjshme, qoftë për shkak të mospërmbushjes së kriterit të ligjshmërisë, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, apo edhe për shkak të mosprovimit të fitimit të tyre në kohën dhe mënyrën e deklaruar.

**13.12.** *Së pari*, nga aktet në fashikull rezultojnë disa mospërputhje. Në deklaratën periodike për vitin 2005, subjekti ka deklaruar të ardhurat [shumën 200.000 lekë] si interesa nga huaja dhënë personit fizik “{\*\*\*}”, ndërsa në deklaratën *vetting* si të ardhura nga interesat e huasë së dhënë personalisht z. S. L.. Sipas subjektit, të ardhurat janë realizuara gjatë vitit 2005. Në deklaratën noteriale të hartuar për efekt të kontrollit nga ILDKPKI-ja<sup>15</sup>, huamarrësi deklaroi se ka marrë hua shumën 1.200.000 lekë, ndërsa në pyetësin nr. 2 subjekti ka pretenduar se huaja ka qenë 1.150.000 lekë. Subjekti nuk ka përcaktuar asnjëherë datë për huadhënien apo kthimin, duke u shprehur në mënyrë të përgjithshme se huaja dhe interesat i janë kthyer “gjatë vitit 2006”, por këto shuma kishte në disponim në momentin kur ka lidhur kontratën e sipërmarrjes për apartamentin objekt analize. Edhe deklarata e hartuar nga huamarrësi është e përgjithshme për kohën kur ai ka marrë huan, pasi nuk përmban shuma dhe momente konkrete, përpos që huaja në shumën 1.200.000 lekë është marrë në vitet 2004-2005. Për të provuar mundësinë financiare të huamarrësit për kthimin e shumës, subjekti ka dorëzuar ekstraktin historik të subjektit tregtar në emër të tij.

**13.13.** Në procesverbalin e datës 18.03.2015, mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar se ka qenë një marrëdhënie mirëbesimi me huamarrësin, të cilit i ka dhënë hua të gjitha kursimet e tij, qoftë *cash* apo në depozitë bankare pas tërheqjes, pa shkresë. Pasi Komisioni e pyeti në mënyrë specifike për periudhën e dhënies dhe kthimit të huas, për efekt të analizës financiare, subjekti është përgjigjur se huan e ka deklaruar si para *cash* në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004

---

<sup>15</sup> Referuar procesverbalit të datës 18.03.2015, në ILDKPKI në fashikull, subjekti është pyetur për të ardhurat nga huadhënia gjatë kontrollit.

dhe 2005, duke deklaruar vetëm shtesat. Subjekti, po ashtu, ka pretenduar se në deklarimin e parë të vitit 2003 ka pasur 100.000 lekë *cash* dhe 450.000 lekë në Bankën e Kursimeve. Gjatë vitit 2004 ka deklaruar shtesë 500.000 lekë nga pagat dhe 55.000 lekë interesa bankare nga depozita e deklaruar. Shuma e dhënë hua, në total prej 1.150.000 lekësh përbëhej nga 450.000 lekë nga depozita dhe 100.000 lekë që ishin para *cash* në fund të vitit 2003, si dhe 500.000 lekë të kursyera gjatë vitit 2004. Nga kjo hua, në fund të vitit 2005, ka përfituar një shtesë prej 200.000 lekësh interesa, të deklaruara si gjendje *cash*.

**13.14.** Nga analiza e kryer në Kolegj, rezulton se subjekti ka pasur mungesë burimesh të ligjshme për të krijuar kursimet e sipërdeklaruara në *cash*, edhe duke kryer llogarinë sipas shpjegimeve të tij më sipër. Konkretisht, subjekti rezulton me një balancë negative të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, përfshirë edhe likuiditetet në bankë dhe jashtë saj, pretenduar të disponuara në vitin 2003, pasi, sikurse analizohet në vijim për apartamentet në Çorovodë<sup>16</sup>, ai rezulton me mungesë burimesh për vitet 1994-2003 në vlerën prej (-) 270.862 lekësh. Së dyti, në deklaraten periodike për vitin 2004, subjekti ka pretenduar se kishte shtuar kursime në *cash*, në shumën 500.000 lekë. Kjo shumë, e vetme apo edhe bashkë me shumën 450.000 lekë në bankë në vitin e mëparshëm, nuk mbulon huanë në vlerën 1.200.000 lekë, edhe duke abstraguat nga balanca negative e burimeve të ligjshme për periudhën 1994-2003 apo nga mospërputhjet në deklarime që kanë rëndësi në kontekstin e besueshmërisë, për si ka ndodhur ekzaktësisht marrëdhënia e huas. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit për aspektet e kontrollit të pasurisë për huan dhe interesat është i bazuar.

**13.15.** Komisioni ka kryer edhe analizën e burimeve që dispononte subjekti, me pikënisje deklaraten për vitin 2006, nga e cila ka rezultuar balancë negative. Nga kontrolli i kësaj analize në Kolegj, rezulton se vlerësimi i kryer nga Komisioni është i bazuar. Konkretisht, ndërsa në vitin 2006 subjekti është shprehur se ka pakësuar vlerën prej 3.800.000 lekësh për të kryer pagesën e apartamentit, shumatorja e kursimeve të disponuara *cash* në banesë dhe bankë deri në fund të vitit 2005 konfirmohet të ishte 1.550.000 lekë<sup>17</sup>. Me rezultatet e hetimit, subjekti është përpjekur ta ndryshojë situatën, duke pretenduar se në fakt kjo vlerë është përlllogaritur gabim, ai duhet të ketë pakësuar përreth 4.200.000 lekë, dhe se atë vit ka kursyer 800.000 lekë dhe jo 400.000 lekë. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka qenë në pamundësi për krijimin e kursimeve të deklaruara, pasi ka rezultuar me një balancë negative në vlerën prej (-) 405.902 lekësh në vitin 2006, edhe duke përfshirë të ardhurat e atij viti. Po ashtu, Komisioni ka theksuar edhe faktin që korrigjimi i kryer pas rezultateve të hetimit është i pabesueshëm e, për pasojë, vlera e pretenduar prej 801.240 lekësh “prezumohet e shpenzuar.”

**13.16.** Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar analizën e sipër përmbledhur të kryer në Komision. Edhe në kontrollin e kryer në Kolegj konfirmohet gjendja financiare e kursimeve sipas

---

<sup>16</sup> Paragrafi nr. 11 e nënpjesët e tij në vendimin e Komisionit.

<sup>17</sup> Në deklaratat periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar gjendjen *cash* në banesë dhe në bankë, si vijon: në deklaraten e parë në mars 2004, për vitin vitit 2003, ka deklaruar 100.000 lekë *cash* në banesë dhe 450.000 lekë në depozitë në Bankën e Kursimeve Skrapar. Kjo shumë është deklaruar në mars 2015 e tërhequr në fillim të atij viti [2015]; në deklaraten për vitin 2004, ka deklaruar 500.000 lekë *cash* dhe në deklaraten për vitin 2005 ka deklaruar 950.000 lekë *cash*.

përlllogaritjes së Komisionit. Po ashtu, çmojmë të theksojmë që Kolegji në mënyrë konsistente i ka vlerësuar në mungesë besueshmërie pretendimet për gjendje të ndryshme financiare që vijnë në faza të avancuara të hetimit siç janë pretendimet që vijnë për herë të parë në prapësim të barrës së provës. Nga korrektimi i disa zërave të analizës së vitit 2006, kryer në Kolegji, balanca negative e konstatuar nga Komisioni u zbut në një vlerë të papërfillshme e konkretisht nga 1.454.662 lekë në 1.433.172 lekë<sup>18</sup>.

**13.17.** Sikurse në Komision, edhe në Kolegji, vitet 2004 e 2005 rezultojnë me një balancë negative për krijimin e shtesës së kursimeve në vlerën 950.000 lekë [arsyetuar në vijim në lidhje me një huadhënie]. Së bashku me pamundësinë financiare për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve në vitet 1994-2003<sup>19</sup> [arsyetuar në vijim në lidhje me apartamentin në Çorovodë], nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të krijonte pasuri dhe kursime për diferencën negative në shumën (-) 270.862 lekë. Në përmbledhje të këtyre konkluzioneve për deklarimin e pasaktë të burimeve të krijimit të kësaj pasurie dhe gjendjen financiare të burimeve të ligjshme, si dhe pasi nuk provoi mundësinë financiare të vëllait dhe babait për të dhënë përkatësisht huan prej 400.000 lekësh dhe dhurimin prej 1.000.000 lekësh subjektit të rivlerësimit, për t'i përdorur si burim për blerjen e apartamentit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka një balancë negative në total në vlerën (-) 1.433.172 lekë, për krijimin e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e germave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

## ***B.2. Apartament me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup> në Berat***

- 14.** Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri<sup>20</sup> përfshirë detajet si sipërfaqja 55 m<sup>2</sup>, blerjen në datën 09.02.2015 dhe çmimin 2.400.000 lekë, burim krijimi është deklaruar një kredi bankare nga Raiffeisen Bank. Subjekti ka deklaruar edhe riparime të kësaj banese, në shumën 285.000 lekë, me burim kursimet e familjes. Në deklaratën për vitin 2015, subjekti ka deklaruar, përpos këtyre të dhënave, edhe “shtesë mobilimi dhe blerje elektro-shtëpiake për apartamentin”, në vlerën 720.000 lekë. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin për këtë pasuri, nuk ka qenë i vërtetë në deklarimet e tij dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive në vitin 2015 në shumën (-) 1.117.301 lekë, që afekton edhe blerjen e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e germave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**14.1.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke potencuar se shpjegimet e tij për mënyrën e blerjes së kësaj pasurie kanë qenë të pamjaftueshme. Duke kundërshtuar përlllogaritjen si shpenzim të një shume prej 550.000 lekësh, të paguar në Alpha Bank, subjekti pretendon se meqenëse apartamenti ka qenë i ngarkuar me barrë hipotekore, vetëm 700.000 lekë nga shuma 1. 250.000 lekë, që ka depozituar për ta liruar nga kjo barrë, i përkisnin atij. Pjesa tjetër

<sup>18</sup> Diferenca është kryesisht pasojë e korrektimit të kursit të këmbimit.

<sup>19</sup> Në Kolegji u krye kontrolli i analizës financiare të Komisionit, për mundësinë e krijimit të kursimeve nga subjekti i rivlerësimit nga viti 1994, kur subjekti u emërua në detyrë deri në vitin 2003, kur është deklaruar prej tij kursimi për herë të parë.

<sup>20</sup> Me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”.

prej 550.000 lekësh i përkiste palës shitëse të apartamentit. Depozitimi i kryer prej tij në shumën në total 1.250.000 lekë kishte për qëllim të mos kryheshin dy veprime bankare. Çmimi 2. 950.000 lekë që ka përllogaritur Komisioni nuk i korrespondon tregut për banesat e kësaj madhësie të ndërtuara para vitit 1970 në atë zonë të Beratit.

**14.2.** Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Edhe në vlerësimin e kryer në Kolegj, shuma e paguar nga subjekti në funksion të krijimit të kësaj pasurie u përllogarit bazuar në pagesat e provuara të kryera nga aktet e kohës, ndërsa pretendimet e subjektit për kthimin në favor të tij të një shume nga shitësit mbetën deklarative. Si rrjedhojë e kësaj analize, edhe në Kolegj, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie dhe shpenzimet e vitit. Në vijim shtjellohet arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion.

**14.3.** Në kontratën e shitblerjes, datë 09.02.2015, palët kanë përcaktuar<sup>21</sup> vlerën 2.400.000 lekë për shitjen e apartamentit dhe referuar se pagesat do të kryheshin si vijon: shuma 700.000 lekë shlyer ditën e hartimit të kontratës, ndërsa pjesa prej 1.700.000 lekësh do të paguhej pas disbursimit të kredisë nga Alpha Bank ka konfirmuar<sup>22</sup> se subjekti i rivlerësimit ka depozituar një vlerë në *cash* në shumën 1.250.000 lekë në datën 21.01.2015, në favor të shitësve, duke referuar qëllimin si *blerje apartamenti*. Gjatë hetimit administrativ, subjekti pretendoi se meqenëse apartamenti ishte i ngarkuar me barrë hipotekore nga shitësit në Alfa Bank, për të marrë kredinë e tij, ai duhet të lironte nga barra apartamentin pronë të shitësve. Për këtë arsye, vetëm 700.000 lekë nga shuma prej 1.250.000 lekësh, depozituar për llogari të shitësve, ishin të subjektit. Pjesa tjetër ishte pasuri e shitësve. Subjekti u shpreh se kjo mënyrë pagese ishte zgjidhje e tij, për të siguruar provë shkresore të dhënies së parave. Për të mënjeluar veprimet e tepërta në sportelin e bankës, shitësi ia dha shumën subjektit që t'i depozitonte. Shuma 700.000 lekë e shënuar në kontratën e blerjes me këtë përkon me pagesën e kryer prej tij në bankë. Ky version faktesh pasqyrohet qoftë në një deklaratë noteriale të lëshuar nga shitësi i apartamentit gjatë procesit të rivlerësimit, në prapësim të rezultateve të hetimit administrativ<sup>23</sup>, sikurse edhe në një deklaratë noteriale të tij, që mban datën 19.06.2015, disponuar e përcjellë nga banka nga e cila subjekti ka marrë një kredi në shumën 1.707.777 lekë, me afat deri në datën 13.03.2025 [Raiffeisen Bank]. Në aktet e përcjella nga Raiffeisen Bank, gjendet edhe një deklaratë noteriale e datës 17.06.2015 e shitësit, i cili shprehet se subjekti/blerësi ka shlyer gjithë detyrimet ndaj tij, në shumën prej 1.700.000 lekësh nëpërmjet Raiffeisen Bank.

**14.4.** Nga dokumentacioni në fashikull, përfshirë edhe atë të përcjellë nga banka, rezulton se në datën 22.01.2015, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr 1.250.000 lekë nga llogaria e tij në Raiffeisen Bank dhe e ka depozituar në llogarinë e shitësve në Alpha Bank, po atë ditë. Së dyti, pasi Raiffeisen

<sup>21</sup> Kontratë noteriale me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 09.02.2015, me palë shitëse [A. dhe K. A.] dhe blerëse subjekti i rivlerësimit, për këtë apartament, me çmimin 2.400.000 lekë. Depozituar në Komision me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 17.01.2020, të AshK-së Berat.

<sup>22</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 26.07.2017, e Alpha Bank.

<sup>23</sup> Nr. {\*\*\*} rep., dhe {\*\*\*} kol., datë 11.09.2020, e deklaruesit A. A., i cili konfirmon pretendimet e subjektit se shuma prej 550.000 lekësh, nga totali 1.250.000 lekë i përkiste atij vetë.



Bank i ka akorduar kredinë në shumën 1.707.000 lekë në datën 04.03.2015, subjekti në datën 17.03.2015 e ka transferuar atë në favor të shitësit me përshkrimin “*Likuidim pagese për blerje shtëpie sipas kontratës së kredisë datë 04.03.2015*”. Subjekti e ka deklaruar këtë kredi në deklaratën periodike për vitin 2015, por pa deklaruar/lidhur atë me një qëllim të caktuar.

**14.5.** Nga sa më sipër, rezulton se në harkun kohor janar - mars 2015, subjekti ka paguar nëpërmjet bankës, në favor të shitësit të apartamentit, shumën prej 2.950.000 lekësh, përbërë nga dy pjesë: *kredia* e marrë nga Raiffeisen Bank dhe *cash-i* i tërhequr nga llogaria e tij bankare në të njëjtën bankë, depozituar në favor të shitësve në Alpha Bank. Në konsideratë të këtyre transaksioneve të dokumentuara, pretendimi i subjektit, se në fakt shitësi i ka kthyer atij një pjesë të kësaj shume apo shpjegimet për arsyet për të cilat palët kanë zgjedhur të veprojnë sikurse është dokumentuar, është i pabesueshëm, pasi është thjesht deklarativ. Jo vetëm nuk ka asnjë gjurmë të kthimit të shumës prej 550.000 lekësh shitësve, por versioni i fakteve të prezantuara nga subjekti është alogjik e nuk bën kuptim nga cilido aspekt i analizuar.

**14.6.** *Së pari*, shuma e likuiditeteve të tërhequra nga subjekti nga njëra bankë dhe depozituar tek tjetra është e njëjtë dhe veprimet kanë ndodhur në të njëjtën ditë. Në këto kushte, probabiliteti që shuma e njëjtë të jetë vetëm rastësi apo që një pjesë e fondeve janë në fakt të shitësit, shtuar prej tij përpara depozitimit nga subjekti, paraqet probleme serioze besueshmërie. *Së dyti*, nëse shitësi/t kishin fonde të mjaftueshme për të përballuar barrën hipotekore për apartamentin, duket e pakuptimtë që të mos kryenin veprimet vetë, duke zgjedhur përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimet bankare të pazakonta që pretendohen, ndërkohë që si subjekt deklarues, sipas ligjit nr. 9049/2003, ai kishte përgjegjësi të shtuar për transparencë e saktësi në deklarime. *Së fundmi*, ky version faktesh është i pabesueshëm edhe pasi pretendohet që shitësit të kenë kontribuar me fondet e tyre në një transaksion bankar në emër dhe për llogari të një blerësi potencial/të ardhshëm, pa krijuar asnjë siguri nëpërmjet një gjurme shkresore/garancie për shumën e cila i përkiste atyre. Për të gjitha këto aspekte, trupi gjykues e gjen të bazuar konstatimin e Komisionit që totali i shumave të paguara nga subjekti në favor të shitësve përbën çmimin e vërtetë të apartamentit.

**14.7.** Në përfundim të sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për mënyrën sesi është vepruar, arsyet e pretenduara si shkas apo përfitimi prej tij mbrapsht i shumës 550.000 lekë, mbetet në nivel deklarativ. Për rrjedhojë, në kushtet që rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit ka transferuar në llogarinë e shitësit të apartamentit shumën prej 2.950.000 lekësh, por jo kthimi mbrapsht i ndonjë pjese të kësaj vlere, u vlerësua i drejtë konkluzioni i Komisionit. Subjekti i rivlerësimit ka paguar për apartamentin shumën e dokumentuar prej 2.950.000 lekësh dhe jo vlerën më të ulët që kanë përcaktuar palët në kontratën e shitblerjes. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit rezulton me pamundësi për krijimin e pasurisë dhe të përballimit të shpenzimeve për vitin 2015 për diferencën negative në shumën (-) 1.018.810 lekë. Po ashtu, subjekti nuk ka deklaruar saktë çmimin e blerjes së kësaj pasurie në deklaratën *vetting*, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germet “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

### ***B.3. Apartamenti i banimit me sipërfaqe 59 m<sup>2</sup> në Çorovodë***

15. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura *neto* në shumën 2. 538.200 lekë nga shitja e dy apartamenteve në Çorovodë, si vijon: (i) i pari blerë në vitin 1999 dhe shitur në vitin 2008, përkatësisht në vlerat 500.000 lekë dhe 2.203.200 lekë, kontratat noteriale përkatëse<sup>24</sup> dhe të ardhurat *neto* 1.533.200 lekë, në të cilën janë zbritur edhe taksat e pasurisë; (ii) apartamenti tjetër me sipërfaqe 59 m<sup>2</sup>, fituar me kontratë *këmbimi* pasurie<sup>25</sup> që mban datën 29.04.2011 dhe shitur në shumën 1.805.000 lekë në datën 17.01.2013<sup>26</sup>. Për këtë apartament, subjekti ka deklaruar të ardhura *neto* 1.005.000 lekë, që janë shuma që rezulton nga zbritja mes shumës së fituar nga shitja e apartamentit të përfituar nga këmbimi me atë të tjetërsuar, që ishte blerë 800.000 lekë. Komisioni ka konstatuar se analiza financiare për periudhën 1994 – 2003 rezulton me mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën (-) 375.482 lekë për blerjen e pasurive, shtimin e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve, për rrjedhojë subjekti gjendet në kushtet e germës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni, po ashtu, ka theksuar se subjekti ka kryer transaksione deklarative pa dokumentacion, veprime të padenja për një magjistrat, i cili duhet të veprojë në përputhje me ligjin, duke shmangur çdo dyshim mbi krijimin e pasurisë dhe të të ardhurave, gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

15.1. Subjekti i rivlerësimit potencon se nëse Komisioni do të përfshinte në analizë edhe shumën prej 200.000 lekësh, që ai pretendon se ia ka dhënë familja pasi ai u larguan nga familja bujqësore në vitin 1994, diferenca negative do të ulej në (-) 175.482 lekë. Po ashtu, ai pretendon se shpenzimet familjare kanë qenë më të ulëta sesa ato që i janë përlllogaritur pasi ai jetonte në qytetin e Çorovodës, nuk ka bërë pushime dhe ka siguruar prej prindërve produkte blegtorale dhe bujqësore të nevojshme për jetesë. Subjekti kërkon që këto pretendime të mbahen në konsideratë në analizën financiare në Kolegj. Gjithashtu, subjekti e konsideron të gabuar përfundimin e Komisionit se me veprimet e tij ka cenuar etikën e magjistratit. Konkluzionin e Komisionit për veprimet e shitblerjes në vitin 1996 si shkelje të Kodit të Etikës duhen vlerësuar në kontekstin e kohës kur ato janë kryer. Banesën që ka dhënë gjatë këmbimit e ka blerë pa dokumentacion nga shitësi në një kohë kur kishte më pak se dy vite përvojë si gjyqtar. Të gjitha veprimet e kryera me këto pasuri kanë ardhur si pasojë e vlerave morale të tij për të mbajtur fjalën e dhënë ndaj shitësit dhe këto veprime nuk kanë cenuar etikën e magjistratit dhe nuk mund të konsiderohen si të tilla.

15.2. Trupi gjykues i Kolegjit mori në analizë për efekt të procesit apartamentin e dytë, shitur në vitin 2013, për efekt të të ardhurave të deklaruar nga shitja e tij në vitin 2013. Transaksionet e tjera pararendëse u analizuan në funksion të deklarimit të të ardhurave *neto* në deklaratën *vetting*. Në këtë linjë, duke mbajtur në fokus saktësinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e apartamentit objekt analize, dhe detyrimin që ka subjekti për të qenë i plotë, i saktë e

<sup>24</sup> Nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 04.04.1999 dhe nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 28.04.2008.

<sup>25</sup> Nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., për apartamentin me nr. pasurie {\*\*\*} me sip. 52 m<sup>2</sup>, e lidhur ndërmjet subjektit dhe E., G. dhe M. D., për këmbimin e apartamentit me sip. 52 m<sup>2</sup>, me çmim reference 829.192 lekë, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, këmbyer me apartamentin me sip. 59 m<sup>2</sup>, me çmim reference 940.814 lekë, në pronësi të palës D..

<sup>26</sup> Me kontratën noteriale të shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 17.01.2013, me palë shitëse Durim Hasa dhe palë blerëse R. H., e apartamentit me sip. 59 m<sup>2</sup>, në shumën 1.805.000 lekë.

shterues për efekt të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi që transaksionet e ndërmarra për blerjen, përveçse janë në kundërshtim me formën e përcaktuar me ligj, pamundësojnë kontrollin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, mbetet e pamundur të konfirmohet vërtetësia e deklarimeve të subjektit në drejtim të çmimit të blerjes, të kohës dhe të mënyrës së veprimit. Arsyetimi mbi të cilin mbështetet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

15.3. Në deklaratën e parë të pasurisë, në mars 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartamentin e parë të referuar më sipër dhe blerjen e tij në vlerën 500.000 lekë, me burim kursimet e tij dhe të bashkëshortes. Gjatë pyetësorëve, ndër të tjera, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për faktin që: (a) ai ka blerë një apartament në lagjen “{\*\*\*}”, në Çorovodë, në korrik 1996, në vlerën 450.000 lekë, të cilin *nuk* e ka deklaruar; (b) subjekti ka deklaruar se jetonte në lagjen “{\*\*\*}”, në periudhën kohore 1996-2008. Nga ana tjetër, apartamenti [me sipërfaqe 72 m<sup>2</sup>] në lagjen “{\*\*\*}”, rezulton i blerë vetëm më 04.04.1999; (c) në deklaratën për vitin 2008 është deklaruar blerje apartamenti në lagjen “{\*\*\*}”, Çorovodë, pa dokumentacion, me çmimin 800.000 lekë; (d) në datën 29.04.2011, me kontratë këmbimi, subjekti ka shkëmbyer apartamentin e referuar në pikën “i” më sipër me një apartament me sip. 59 m<sup>2</sup> në pronësi të familjes D.. Subjekti ka përfituar një apartament më të madh nga shkëmbimi dhe, për pasojë, me vlerë më të lartë; (e) likuidimi i çmimit të shitjes tërësisht jashtë zyrën noteriale është në kundërshtim me ligjin nr. 7829/1994 “Për Noterinë” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë/Ministrisë së Financave nr. 6915/2, datë 30.01.2012.

15.4. Nga shpjegimet e subjektit, rezulton se në korrik të vitit 1996 ka blerë me dokumentacion: (i) apartamentin në lagjen “{\*\*\*}”, të cilin e ka shkëmbyer në vitin 2011. Ndërkohë, subjekti ka blerë pa dokumentacion; (ii) apartamentin 59 m<sup>2</sup> në lagjen “{\*\*\*}” kundrejt çmimit 370.000 lekë. Me fjalë të tjera, shkëmbimi nuk ka ndodhur. Apartamenti i blerë ishte përfituar nga shitësi nga EKB-ja dhe ishte në proces shlyerje me këste. Për këtë shkak, palët lidhën kontratë shkëmbimi deri kur “të përfundonte pagesa e apartamentit”. Të njëjtin apartament, në mars 1999, subjekti i rivlerësimit ia ka shitur një pale të tretë [I. Z.], ndonëse nuk e kishte blerë me dokumentacion. Shitja sipas kësaj kontrate të re ishte kundrejt vlerës 400.000 lekë; (iii) më 04.04.1999m subjekti bleu (*de jure*) një apartament tjetër, me sip. 72 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, kundrejt çmimit 500.000 lekë. Këtë apartament, subjekti e ka shitur në datën 28.04.2008, në vlerën 2.203.200 lekë. Ky apartament dhe ai me sip. 59 m<sup>2</sup> (referuar si “i” më sipër] ishin në të njëjtin pallat, në dy kate të ndryshme. Duke qenë se apartamenti i dytë [me sipërfaqe 59 m<sup>2</sup>] nuk mund të regjistrohej, pasi shitësi, familja D., *nuk* kishte përfunduar pagesat për shlyerjen e tij, blerësi pa dokumentacion [z. I. Z.] ia ktheu apartamentin subjektit në vitin 2008, duke i kërkuar 800.000 lekë kundrejt 400.000 lekë të referuar si çmim blerjeje, për shkak të rritjes së vlerës në periudhën kohore në fjalë 1999-2008.

15.5. Për të provuar sa më sipër, subjekti dorëzoi në Komision një deklaratë noteriale<sup>27</sup> të blerësit të tretë, që konfirmon ngjarjet sipas shpjegimit të subjektit. Deklaruesi, po ashtu, shprehet se ka jetuar në apartamentin objekt analize deri në vitin 2008 dhe që në kushtet kur subjekti nuk i formalizoi dokumentet e shtëpisë dhe ai duhet të largohej nga qyteti i Çorovodës në vitin 2008, i

---

<sup>27</sup> Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 13.01.2021, lëshuar nga z. I. Z..

shiti subjektit edhe banesën që kishte në të njëjtin pallat sërish pa dokumente, për çmimin 800.000 lekë.

**15.6.** Rezulton se subjekti ka deklaruar vetëm pjesërisht veprimet e mësipërme. Konkretisht, në deklaratën periodike për vitin 2008 ai ka deklaruar blerjen “pa dokumente” të apartamentit në vlerën 800.000 lekë, dhe regjistrimin e saj në deklaratën periodike vjetore për vitin 2011. Subjekti nuk ka deklaruar shkëmbimin e apartamentit apo detajet e referuara prej tij vetëm pasi është pyetur në mënyrë specifike nga Komisioni. Po ashtu, gjatë hetimit Komisioni, konstatoi se çmimi i paguar prej subjektit për apartamentin objekt analize ishte shumë më i ulët sesa vlera e tij, sipas shitjes nga EKB-ja<sup>28</sup> familjes D. – përkatësisht 572.000 lekë kundrejt 370.000 lekë -- Komisioni nuk u bind për vlerën reale të paguar nga subjekti për këtë pasuri. Si rrjedhojë, për efekt të analizës financiare, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të periudhës 1994 – 2003 si shpenzim për apartamentin shumën e deklaruar nga subjekti për apartamentin tjetër [me sip. 52 m<sup>2</sup> me të cilin kjo pasuri pretendohet të jetë shkëmbyer] prej 450.000 lekësh.

**15.7.** Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, në funksion të krijimit të kësaj pasurie me burime të ligjshme, subjekti rezultoi me balancë negative, edhe duke abstraguara nga transaksionet e shumëfishta e shpjegimet deklarative. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë blerjen e dy apartamenteve, në vitet 1996 dhe 1999, në Çorovodë [referuar në paragrafin 15.4 si apartamentet “i” dhe “iii”], përkatësisht në vlerat 450.000 lekë dhe 500.000 lekë. Nga ana tjetër, në analizën financiare nuk u përfshi shuma e pretenduar prej 200.000 lekësh si e përfituar në momentin e shpërbërjes së familjes bujqësore, sipas arsyetimit të shtjelluar në detaj në paragrafin 13.4. e 13.5., ndër të tjerë. Sikurse referuar më sipër, balanca negative që rezulton në Kolegj, për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për periudhën deri në vitin 2003, pas korrektimit të kryer në Kolegj është (-) 270.862 lekë. Ndonëse më e ulët sesa ajo e përlogaritur nga Komisioni<sup>29</sup>, korrektimi i vlerës nuk sjell një peshë përcaktuese.

**15.8.** Në përfundim të sa më sipër, edhe në analizën e kryer nga trupi gjykues i Kolegjit rezulton se subjekti ka kryer një sërë transaksionesh *pa dokumentacion* dhe në kundërshtim me ligjin, përfshirë blerjen e një apartamentit nga një individ që nuk kishte të drejtë ta shiste, veprimet e shitjes më pas e riblerjen e një pasurie për të cilën nuk kishte titull pronësie. Subjekti i rivlerësimit është përfshirë në transaksione të cilat vijnë përbëjnë veprime juridike të pavlefshme<sup>30</sup>, duke injoruar minimalisht parimet ligjore që gjejnë zbatim për tjetërsimin e pronësisë së paluajtshme. Përveç dispozitave materiale civile, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë zgjedhur të veprojë në informalitet, në mënyrë të përsëritur, për arsye të pashpjeguara prej tij. Nga ana tjetër, në kushtet që deri në vitin 2006, në Shqipëri, nuk kishte ende një grup parimesh të formalizuara, sikurse Kodi i Etikës Gjyqësore [miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, më datë 08.12.2006], ndryshe

---

<sup>28</sup> Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se në datën 02.03.2011, E., G. dhe M. D. në cilësinë e palës blerëse, kanë lidhur me kontratën për blerjen e këtij apartamenti me EKB-në dhe kanë paguar gjithsej shumën 572.000 lekë.

<sup>29</sup> Referuar paragrafit 11.33, balanca negative e analizës së viteve 1999-2003 është (-) 375.482 lekë.

<sup>30</sup> Neni 83, paragrafi i parë i Kodit Civil parashikon që: “Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm”.

nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit *nuk* i konsideroi këto veprime si shkelje etike, pasi e kundërta do të ishte shkelje e parimeve të së drejtës për fuqinë prapavepruese të normave. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në kontrollin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në kushtet që veprimet e subjektit janë tërësisht deklarative, pretendimet e tij të mbeten në nivelin e deklarimeve, vërtetësia e të cilave mbetet e pamundur për t'u verifikuar në drejtim të kohës dhe çmimit të shitblerjes së pasurisë.

#### **B.4 Analiza financiare**

16. Pasi ka kryer edhe analizën financiare të periudhës së rivlerësimit, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka mungesë burimesh financiare për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive në (-) vlerën 4.743.825 lekë. Në këtë konkluzion, Komisioni ka mbajtur në konsideratë problematikën me të ardhurat nga qiraja e një njësie tregtare për thuajse katër (4) vite, të ardhurat e djalit të subjektit nga punësimi informal dhe të ardhurat e pretenduara nga shitja e disa artikujve nga aktiviteti i bashkëshortes, përpos atyre të arsyetuara më sipër në këtë vendim.

16.1. Subjekti i rivlerësimit kërkon të pranohen të ardhurat *nga qiraja* që ai ka deklaruar, duke argumentuar se pagesa e tatimeve për të ardhurat nuk ka qenë detyrimi i tij, por i qiramarrësve që kanë ushtruar biznes. Po ashtu, ai potencon se ka paraqitur në Komision provën e pagesës së detyrimeve. Shuma 25.000 lekë në muaj përbënte pagesën e qirasë *neto*. Qiramarrësja ka paguar në Komunën Dajt edhe taksën mbi ndërtesën, e cila është në pronësi të subjektit. Kjo do të thotë se ndryshe nga Komuna Dajt, institucionet e tatimeve nuk e kanë kryer detyrën e tyre për mbledhjen e tatimeve. Për sa i përket *të ardhurave të të birit*, subjekti thekson se i ka deklaruar në deklaratat e pasurisë, sepse kanë hyrë në ekonominë familjare. I biri është punësuar në dhjetor të vitit 2013 nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, i padeklaruar në listëpagesat e subjektit privat. Subjekti pretendon se ka paraqitur dokumentacion provues për marrëdhënien e punësimit në fjalë. Detyrimi për pagesën e kontributeve ka qenë i punëdhënësit dhe strukturave shtetërore. Ka sjellë 30 e-mail-e si provë për marrëdhënien e punësimit, që kërkon që t'i merren në Kolegj. *Të ardhurat prej 800.000 lekësh* të përfituara nga shitja e artikujve të ndryshëm ushqimorë të aktivitetit privat të mbyllur të bashkëshortes së tij, gabimisht nuk janë deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011, por mund të provohen nga kontrata e qirasë për njësinë, ku qiramarrësja ka pranuar se ka blerë edhe mjetet e xhiros në shumën prej 800.000 lekësh. Në vitin 2009 ka deklaruar në deklaratën periodike pakësim të gjendjes *cash* në vlerën 800.000 lekë, prej të cilave 700.000 lekë janë investuar për të shtuar xhiron e bashkëshortes, ndërsa pjesa tjetër për blerjen e njësisë. Komisioni ka gabuar duke konkluduar që kjo shumë duhet të ishte ligjësuar duke paguar tatimin në burim, pasi blerësi i mori këto mallra me qëllim të vazhdimit të aktivitetit. Nga kjo shitje nuk është realizuar fitim shtesë në mënyrë të tillë që diferenca të tatohej. Kjo vlerë është tatuar më parë.

16.2. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimet e subjektit janë të pabazuara. Në kushtet që nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të kryer nga Komisioni, të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e njësisë tregtare me sip. 32,5 m<sup>2</sup>, të ardhurat e përfituara nga puna e djalit të subjektit, si dhe të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga shitja e artikujve të ndryshëm

ushqimorë, nuk plotësojnë kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës<sup>31</sup>, sikurse as nuk janë provuar për ekzistencën e tyre në masën e deklaruar, në mungesë të ndonjë dokumentacioni të kohës. Për rrjedhojë, edhe në analizën e kryer në Kolegj, këto të ardhura nuk u përfshinë në funksion të analizës financiare. Nën dritën e garancive procedurale në ankim, në Kolegj konfirmohet balanca negative e konstatuar në analizën përfundimtare të Komisionit, e referuar në vlerën (-) 4.743.825 lekë, megjithëse sipas metodologjisë financiare të përdorur në Kolegj, diferenca negative do të rezultonte më e lartë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për të krijuar pasuritë dhe përballuar shpenzimet, duke e vendosur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Në vijim shtjellohet arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit mbi të cilin mbështetet ky konkluzion.

**16.3.** Në deklaratën *vetting dhe në deklaratat periodike për vitet 2012-2016*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga dhënia me qira e një njësie shërbimi në Tiranë, për vitet 2012-2016, në total shumën 1.320.000 lekë. Komisioni nuk ka përfshirë në analizën e burimeve të ligjshme një vlerë të ardhurash prej 1.140.000 lekësh, nën dritën e nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, që përkon me periudhën dhjetor 2011 - shtator 2015, pasi ka konstatuar se ato janë të ardhura të pa tatuara. Në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton një kontratë *jo noteriale* qiraje me afat trevjeçar, mes subjektit e bashkëshortes dhe një individi, në cilësinë e qiramarrëses së njësisë tregtare. Kontrata referon edhe orendi që janë pjesë e qirasë. Çmimi i përcaktuar nga palët është 25.000 lekë në muaj. Qiramarrësja nuk rezulton të ketë qenë e regjistruar për tatimin në burim<sup>32</sup> e, rrjedhimisht, nuk ka pagesa për këtë lloj tatimi. Po ashtu, rezulton edhe që subjekti ka kryer pagesën e tatimeve në datën 19.04.2021, që përkon me ditën kur për të zhvillohej seanca dëgjimore në Komision.

**16.4.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në kushtet që marrëdhënia e qirasë është lidhur me një individ, pretendimet e subjektit se shlyerja e detyrimit tatimor binte mbi qiramarrësen janë të pabazuara në ligj. Ky kuptim rezulton qartë nga ligji i kohës<sup>33</sup>, i cili në nenet 4 germa “gj” dhe 8 germa “d” parashikonte qiranë si një ndër të ardhurat e tatueshme për atë që është përfitues – në këtë rast, subjekti/qiradhënësi – dhe përcaktonte si mënyrë menaxhimi të këtij detyrimi mbajtjen *në burim* nëse qiramarrësi është subjekt tregtar/person fizik<sup>34</sup>. Nga aktet nuk rezulton që qiramarrësja ta ketë deklaruar këtë cilësi, qoftë në kontratën e lidhur me subjektin, sikurse edhe as në raport me administratën tatimore. Për më tepër, në kushtet që kontrata referon qiranë në vlerën 25.000 lekë, pa specifikuar *bruto* apo *neto*, si dhe pa një parashikim për palën e cila merrte përsipër detyrimin tatimor, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin sipas prezumimit ligjor si përfituesi i të ardhurës. Këtë fakt e mbështet edhe fakti që subjekti e pretendon dhe deklaron të ardhurën në vlerën *bruto* 25.000 lekë në muaj, që nënkupton që ai vetë ka qenë i ndërgjegjshëm se kjo vlerë nuk mund t’i ishte nënshtruar tatimit. Për pasojë, përjashtohet mundësia për të argumentuar

<sup>31</sup> Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, citon: “[...] Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore [...]”.

<sup>32</sup> Referuar shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me nr. {\*\*\*} prot., datë 15.02.2021.

<sup>33</sup> Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, aktualisht i shfuqizuar.

<sup>34</sup> Neni 33 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, aktualisht i shfuqizuar.

mirëbesim të subjektit apo mungesë dijenie. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të bazuar qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të të ardhurave nga qiraja, të cilat nuk kalojnë testin e ligjshmërisë, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

**16.5.** Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur/djali i subjektit ka deklaruar të ardhura nga paga në vitet 2014 dhe 2015 në total prej 540.000 lekësh. Deklaruesi referon punësim informal në shërbime interneti. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se flitet për punësimin e parë të të birit, që ka qenë pa sigurime, por të ardhurat janë realizuar. Si dokumentacion provues, subjekti ka paraqitur disa e-mail-e të punës së djalit për periudhën dhjetor 2013 - prill 2015. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni nuk i përfshiu të ardhurat e djalit të subjektit nga punësimi në analizën financiare të subjektit, pasi konkludoi se nuk kalojnë testin e ligjshmërisë, sipas pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 19, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

**16.6.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pavarësisht se në deklaratat periodike dhe *vetting* subjekti/personi i lidhur ka deklaruar një sasi të ardhurash, në kushtet e mungesës së plotë të dokumentacionit provues për marrëdhënien e punësimit, qoftë edhe në mënyrë indirekte – nëpërmjet akteve në formën e vërtetimit, kontrata afatshkurtra apo produkte të punës/marrëdhënies me shoqërinë nga e cila pretendohen të ardhurat – pretendimet e subjektit mbetën tërësisht deklarative edhe vetëm për nivelin sasior të të ardhurave të deklaruara, që lë jashtë diskutimit testin e ligjshmërisë, sipas Aneksit të Kushtetutës e ligjit. Të ardhurat nga punësimi nuk mund të deduktohen as nga llogaritë bankare të personit të lidhur/djalit të subjektit të rivlerësimit, për periudhën 2014 dhe 2015, pasi nuk rezulton asnjë depozitim me përshkrimin “pagë” nga punëdhënësi i deklaruar [ “{\*\*\*\*}”]. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të bazuar qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të të ardhurave të deklaruara nga punësimi i djalit të subjektit për vitet 2014 dhe 2015.

**16.7.** Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit *nuk* ka deklaruar të ardhura të përfituara nga shitje artikujsh gjatë vitit 2011. Në deklaratën periodike për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesë *cash* në banesë dhe në llogarinë e tij në bankë [Raiffeisen Bank] nga kursimet, si dhe nga mbyllja e biznesit të bashkëshortes dhe shitja e artikujve të aktivitetit, në total 1.450.000 lekë. Në rubrikën e të ardhurave të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar të ardhura nga biznesi i bashkëshortes në vlerën 720.000 lekë së bashku me qiranë e përfituar në fund të vitit 2011. Komisioni ka vlerësuar të mos përfshijë shumën 800.000 lekë në mesin e të ardhurave të disponuara nga subjekti, pasi ato *nuk plotësojnë* kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Nga dokumentacioni në fashikull<sup>35</sup>, konfirmohet aktiviteti i bashkëshortes së subjektit në harkun kohor korrik 2009-shkurt 2012 dhe kontrata e qirasë për njësinë, referuar më sipër. Bashkë me qiranë, palët kanë rënë dakord se me dorëzimin e njësisë, qiramarrësja do të blinte nga qiradhënësja të gjithë artikujt ushqimorë, kundrejt çmimit 800.000 lekë, të paguar në *cash*.

---

<sup>35</sup> *Regjistrimi dhe çregjistrimi në QKB dhe vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Dajt, me nr. {\*\*\*} prot., datë 24.02.2021, sipas së cilit bashkëshortja e subjektit ka ushtruar aktivitetin si person fizik, tregti e artikujve me pakicë, për periudhën 2009-2012 dhe ka paguar taksat vendore.*

**16.8.** Trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të bazuar konkluzionin e Komisionit. Përpos faktit që edhe subjekti ka qenë kontradiktor në deklarimin e sasisë dhe zërit që përfaqësonte ekzaktësisht shitja e artikujve në deklaratën periodike apo heshtjen tërësisht për të në deklaratën *vetting*, rezulton se i vetmi akt ku referohet ekzistenca e një të ardhure të këtij lloji është një kontratë qiraje jonoteriale. Në këto kushte, kjo kontratë në vetvete është e pamjaftueshme të përbëjë provë të kohës për kur është hartuar apo për sa referon në përmbajtje. Për më tepër, subjekti nuk ka dhënë një vlerë specifike as në deklaratën periodike të vitit, duke zgjedhur të japë një përshkrim të përgjithshëm të shtesës së *cash*-it në një vlerë të përgjithshme. Pretendimet e subjektit mbetën në nivelin deklarativ dhe të paprovuara me asnjë akt të kohës. Në kushtet kur nuk ka asnjë të dhënë për të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga aktiviteti i mbyllur, asnjë dokumentacion tjetër që provon se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur gjendje inventari mallra në ndonjë shumë çfarëdo, nuk rezultoi që kjo e ardhur të jetë deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011 apo më pas apo të ketë gjurmë që subjekti e ka përfituar në rrugë bankare, me faturë apo ndonjë akt tjetër që të shërbente si indicie. Si rrjedhojë, në kushtet që subjekti nuk ka provuar ekzistencën e shumës në fjalë, përjashtohet nevoja për të analizuar nëse ato kalojnë testin e ligjshmërisë, sipas Aneksit të Kushtetutës. Sa më sipër, gjendet i drejtë konkluzioni i Komisionit për të mos përfshirë shumën 800.000 lekë në mesin e të ardhurave të disponuara nga subjekti i rivlerësimit në analizën financiare të vitit 2011.

**16.9.** Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konfirmon konkluzionin e Komisionit se nga analiza e shkaqeve të ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi ai ka kryer deklarime të pasakta dhe mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurive e përballimin e shpenzimeve, në kundërshtim me germën “a” dhe sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të të njëjtit ligj.

### **C. Vlerësimi tërësor**

- 17.** Në përfundim të kontrollit të kriterit të figurës dhe atij të vlerësimit profesional, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Ky konkluzion u bazua në sa ka rezultuar nga analiza e disa indicieve të përcjella nga organet verifikuese për përfshirje të subjektit në veprime korruptive apo të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm për të favorizuar të pandehurit, me fokus dy çështje penale të shqyrtuara nga subjekti, si dhe në qëndrimin e Komisionit në përfundim të analizës për veprimet e kryera me apartamentet në Çorovodë [shtjelluar më sipër] dhe në shqyrtimin e çështjes me palë huamarrësin [z. S. L.], referuar shkakut të ankimit të analizuar më sipër në vlerësimin e pasurisë, në paragrafët 13.9 - 13.14. Raporti i grupit të punës së DSIK-së e vlerësoi subjektin të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës, në kontekstin e kontrollit të figurës. Konkluzioni i Komisionit është rezultat i hetimit të pavarur të kryer për të dy këto kritere vlerësimi, referuar edhe informacionit të përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme për pesë kallëzime penale në ngarkim të subjektit në vitet 2017-2019, dhe një procedimi penal të Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.

**17.1.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton nëpërmjet ankimit konkluzionet e mësipërme. Në mënyrë të përmbledhur, për konkluzionet që lidhen me këtë shkak ankimi, subjekti argumenton se:



i) informacioni në raportin e DSIK-së nuk plotëson kriteret e nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, sikurse as nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016. Raporti nuk mbështetet në asnjë verifikim, dhe nuk bazohet në prova; për pasojë duhet të konsiderohet i pavlerë për kontrollin e figurës;

ii) vendimi i marrë prej tij për huamarrësin [z. S. L.] kishte përfunduar 9 vite përpara se ai të jepte një vendim. Kontrata e huasë nuk është marrë në konsideratë prej tij pas aq shumë vitesh dhe në çështjen gjyqësore që ka shqyrtuar, ka respektuar ligjin;

iii) për procedimin tjetër, lidhur me çështjen gjyqësore që i përket A. M., ka takuar xhaxhain e të pandehurit në rrethana rastësore. Kur jetonte në Çorovodë e ka njohur si banor i të njëjtit pallat me të. Takimi është kërkuar prej fqinjit të përbashkët, ndërsa subjekti nuk e dinte se ishte xhaxhai i të pandehurit, çështjen e të cilit do ta gjykonte, apo që të jetë i përfshirë në vepra penale. Gjatë atij takimi nuk ka pasur përpjekje për ndikim të paligjshëm.

iv) në çështjen që i përket B. I., etj., ka vendosur për zbutjen e masës së sigurimit për të dyshuarin pasi nevojat kishin ndryshuar. Meqenëse veprat penale për të cilat akuzoheshin dy të pandehurit ishin më të lehta se ajo e parashikuar nga neni 134, paragrafi 2 i Kodit Penal, arresti në burg nuk ishte masa e vetme e përshtatshme, dhe ka vendosur detyrimin për paraqitje. Prokuroria ka arritur në përfundimin që dy të pandehurit nuk kishin vepruar në bashkëpunim. Të pandehurit nuk i janë fshehur hetimit dhe gjykimit, dhe nuk është provuar se kanë kryer vepër tjetër penale apo kanë bërë përpjekje për të fshehur provat. Ky fakt provon drejtësinë e vendimit të dhënë prej tij;

v) për procedimin penal të Prokurorisë për Krimet e Rënda [procedimi me nr. {\*\*\*}, datë 25.09.2018], është njohur për herë të parë në raportin për rezultatet e hetimit të Komisionit. Hetimi në ngarkim të tij është regjistruar mbi të dhëna të pavërteta. Marrëdhëniet e tij me palët gjatë këtij procedimi, kanë qenë vetëm ato të seancave gjyqësore. Në asnjë rast nuk ka dhënë këshilla lidhur me çështjet e gjykuara prej tij apo çështje të tjera. Në vijim, është informuar se Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin e Krimit e Organizuar ka vendosur pushimin e çështjes penale në datën 07.01.2021.

**17.2.** Trupi gjykues i Kolegjit, sikurse edhe Komisioni, i vlerësoi këto aspekte në drejtim të vlerësimit tërësor. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se konkluzioni i Komisionit është i bazuar dhe subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprime e marrë vendime, të cilat parë në këndvështrimin e perceptimit të publikut, cenojnë besimin tek drejtësia. Ky konkluzion, sikurse shtjellohet në detaj në vijim, mban në konsideratë vendimmarrjen e subjektit në kushtet e papajtueshmërisë në çështjen penale me të pandehur një person të cilin subjekti e kishte mik [z. S. L.], takimet e subjektit me dy individë të ndryshëm në funksion të vendimmarrjes në çështjen e vitit 2019 për të pandehurin A. M., vendimmarrjen e subjektit në favor të të pandehurit B. I., sa rezulton nga organet ligjzbatuese, dhe një vlerësim të përgjithshëm të akteve, nga të cilat pasqyrohet një mënyrë pune e subjektit që bie ndesh me pozicionin e tij dhe me pritshmëritë për paanësi e objektivitet në dhënien e drejtësisë, që pritet prej një magjistrati. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në detaj në vijim.

**17.3.** Nga aktet në fashikull rezulton se Komisioni është informuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat edhe mbi dy vendime të marra nga subjekti i rivlerësimit, përkatësisht në nëntor 2014 dhe janar 2015, duke zbutur masën e sigurimit, në të dyja rastet. Konkretisht, në rastin e parë, subjekti

ka vendosur<sup>36</sup> të vleftësojë të paligjshëm arrestimin në flagrancë, si dhe të caktojë për z. S. L. detyrimin për t'u paraqitur në policinë gjyqësore. Ky vendim është ankimuar nga prokurori dhe në vijim rrëzuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila ka urdhëruar arrestin në burg<sup>37</sup> të të dyshuarit, lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë. Në vendimin e dytë, subjekti ka pranuar<sup>38</sup> kërkesën e të dyshuarit për zëvendësimin e masës së sigurisë dhe ka vendosur në janar 2015 arrestin në shtëpi, për shkak të arsyeve shëndetësore. Në përfundim të çështjes së themelit për këtë të akuzuar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat e ka deklaruar të pandehurin të pafajshëm për veprat penale për të cilat është hetuar, vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike.

17.4. Komisioni ka konkluduar përfundimisht se vendimmarrjet e subjektit për këtë të dyshuar janë kryer në kushtet e papajtueshmërisë. Së bashku me konkluzionet e tjera në vlerësimin nën aspektin pasuror të huadhënies dhe përfitimit të interesave prej saj [analizuar në paragrafin 13 më sipër], Komisioni ka konstatuar se subjekti është gjendur edhe në kushtet e konfliktit të interesit, në kuptim të gërmasë “d” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti duhet të kishte hequr dorë nga gjykimi i çështjes për shkak të miqësisë me të pandehurin/dyshuarin. Trupi gjykues i Kolegjit ndan mendim të ngjashëm me Komisionin për nga cilësimi juridik, duke e vlerësuar të drejtë qoftë konkluzionet e sipër-arsyetuara në kontrollin e pasurisë, sikurse edhe faktin që subjekti ka gjykuar në kushtet e papajtueshmërisë për shkak të marrëdhënies së miqësisë që është shprehur se kishte me z. L..

17.5. Sipas shpjegimeve të subjektit, marrëdhënia e huas me interes ka pasur për bazë njohjen e ndërsjellë mes tij dhe huamarrësit. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon me rëndësi të theksojë dy aspekte: *së pari*, *koha* kur është krijuar e ka përfunduar marrëdhënia e huas është *e padokumentuar*. Mungojnë akte të kohës nëpërmjet të cilave të dokumentohet ekzaktësisht fillimi e mbarimi i marrëdhënies juridike në fjalë, përveç deklaratës periodike vjetore për vitin 2005, në të cilën subjekti ka deklaruar përfitimin e interesit në shumën 200.000 lekë nga huadhënia me interes [20%]. Nuk ka asnjë akt tjetër të palëve në vitet 2004-2005 apo në vitin 2006, në kushtet që marrëdhënia nuk është pasqyruar ndër vite në deklaratat periodike. Akti i parë i hartuar nga palët është deklarata noteriale e huamarrësit në mars 2015, gjatë dhe në funksion të kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja për subjektin. Kjo deklaratë rezulton të jetë hartuar pak javë pasi subjekti, në janar 2015, kishte dhënë vendimin e dytë për zbutjen e masës së sigurimit personal për huamarrësin, duke zëvendësuar masën e arrestit me burg të vendosur nga Gjykata e Apelit Vlorë. *Së dyti*, edhe duke abstraguar nga gjithë sa më sipër, në kushtet që subjekti pranon se huamarrja kundrejt interesit 20% kishte për bazë miqësi të vjetër, fakti që marrëdhënia juridike ka përfunduar, pavarësisht nga kur, është pa peshë përcaktuese. Vendimmarrja në kushtet e miqësisë me të dyshuarin vë në pikëpyetje objektivitetin e subjektit dhe duhet të ishte bërë shkas që ai të jepte dorëheqjen. Disa javë pasi subjekti ka marrë vendimin e dytë për zbutjen e masës së sigurimit, huamarrësi ka lëshuar edhe deklaratën noteriale të përdorur nga subjekti gjatë kontrollit në ILDKPKI për të shpjeguar deklarimin e tij në deklaratën e 10 viteve më herët për fitimin e interesit në shumën 200.000 lekë.

<sup>36</sup> Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 02.11.2014.

<sup>37</sup> Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.12.2014.

<sup>38</sup> Vendimi nr. {\*\*\*}, datë 20.01.2015.

17.6. Nën dritën e dispozitave ligjore të zbatueshme, konkretisht germa “ë” e pikës 1 të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit për konfliktin e interesit, germa “a” e nenit 4, lexuar bashkë me nënpikën “v” të paragrafit 1 të nenit 5, subjekti duhet të kishte dhënë dorëheqjen për shkak se marrëdhënia e miqësisë përbën shkak serioz njëanshmërie<sup>39</sup> dhe përbën një ndër interesat private të referuar në mënyrë të shprehur nga ky ligj<sup>40</sup>. Nga ana tjetër, në kushtet që *përfundimi* i marrëdhënies së huas *përpara* vendimmarrjes së subjektit në procesin penal, mbeti deklarativ e nuk u provua me asnjë dokument të kohës, përpos deklaratës së hartuar nga huamarrësi pak javë pasi subjekti shqyrtoi e pranoi kërkesën e tij, trupi gjykues i Kolegjit vëren se është e pamundur të përjashtohet ekzistenca e marrëdhënies debitor-kreditor mes gjyqtarit dhe palës në vendimmarrjen në dhjetor 2014 apo janar 2015, aspekt i parashikuar në mënyrë të shprehur si shkak për heqjen dorë në dispozitat procedurale që rregullojnë paanësinë e gjyqtarit të procesin penal [germa “a” e pikës 1 të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale]<sup>41</sup>.

17.7. Komisioni e ka cilësuar këtë situatë si konflikt interesi sipas nenit 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe nëse ky konkluzion është bazuar në mosprovimin e përfundimit të marrëdhënies së huas, në kushtet që në kohën kur subjekti pretendon të ketë krijuar përfitime financiare [nga interesat] nuk është provuar që ai të ketë marrë edhe vendime që afektojnë huamarrësin, pasojat e veprimeve të subjektit nuk mund të shihen si derivat në krijimin e pasurive nga subjekti. Në kontekstin e procesit të rivlerësimit, dispozita në fjalë duhet të analizohet në raport me krijimin e pasurive nga subjektet e rivlerësimit. Pasojat e mosjustifikimit të ligjshmërisë së burimeve të pasurive do të vinin kur këto pasuri janë krijuar si rezultat dhe nëpërmjet gjendjes së konfliktit të interesave. Si rrjedhojë, në analizën e kryer në Kolegj, ky konstatim u përfshi vetëm në kontekstin e vlerësimit të aftësive profesionale e atij tërësor për subjektin e rivlerësimit, në një lexim harmonik të dispozitave për paanësinë e magjistratit si shfaqje e angazhimit etik dhe profesional<sup>42</sup> dhe të efektit që kanë veprimet e subjektit, parë në këndvështrim të perceptimit nga publiku dhe efektin mbi besimin që ato krijojnë në sistemin e drejtësisë.

---

<sup>39</sup> Neni 17, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale parashikon: “Gjyqtari ka detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie”.

Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, në germën “a” të pikës 4, parashikon: “Konflikt faktik i interesit” është gjendja, në të cilën interesat private të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij zyrtare” dhe germa “i/dh” e pikës 1 të nenit 5, po aty, sipas së cilit: “[...] 1. Interesat private të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: [...] dh) marrëdhënie [...] (v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë; [...]”.

<sup>40</sup> Pika 1 e nenit 3 parashikon: “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejta ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike”.

<sup>41</sup> “Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit ose i fëmijëve të tij”.

<sup>42</sup> Neni 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, parashikon që: “[...] 4. Paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave, matet duke u bazuar në tregues të tillë si përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magjistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi”.

17.8. Në përfundim të sa analizuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi që subjekti i rivlerësimit, minimalisht në versionin e paraqitur prej tij – ekzistencën e marrëdhënies miqësore afatgjatë me një palë në një proces të ndjekur prej tij – ka qenë në kushtet e *papajtueshmërisë* dhe duhet të kishte kërkuar dorëheqjen. Nëse kjo analizë mban në konsideratë që subjekti nuk arriti të provojë gjatë procesit se në fakt marrëdhënia e interesit mes tij dhe palës/të dyshuarit nuk kishte përfunduar në kohën kur janë dokumentuar dy vendime të marra prej tij në favor të këtij individi, situata e papajtueshmërisë që paraqitet nuk le vend për kontestim. Këto veprime të subjektit, në mospërfillje të dispozitave ligjore apo të mënyrës sesi ato përcillen në publikun e gjerë, nuk mund të mos cenojnë përshtypjen e publikut për mënyrën sesi funksionarët e drejtësisë zbatojnë ligjin gjatë ushtrimit të detyrës në raport me rrethin e tyre miqësor apo me individë me të cilët kanë marrëdhënie interesi. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit për ta përfshirë këtë situatë në rrethin e konstatimeve për të cilat ka gjetur zbatim pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

17.9. Aspekti tjetër mbi të cilin Komisioni ka konstatuar cenim të besimit të publikut nga subjekti, është pasojë e analizës së indicieve që kanë rezultuar nga raporti i DSIK-së, për papërshtatshmëri. Sipas raportit të deklasifikuar pjesërisht të DSIK-së, subjekti dyshohej të jetë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme<sup>43</sup>. Në vijim, Komisioni ka hetuar për dy çështje penale të shqyrtuara nga subjekti, për të pandehurin B. I., për veprën penale të vjedhjes në bashkëpunim, në vitin 2018 dhe në çështjen në ngarkim të A. M., akuzuar për veprën penale “Vjedhje me dhunë” në bashkëpunim, në vitin 2017. Trupi gjykues i Kolegjit, i gjeti të bazuara konkluzionet e Komisionit. Në vijim shtjellohet analiza për secilën prej çështjeve, renditur në mënyrë kronologjike.

*Çështja gjyqësore që i përket të pandehurit A. M.*

17.10. *Së pari*, nga dokumentacioni në fashikull rezulton se gjatë periudhës 2017-2019, subjekti ka kryesuar një trup gjykues i cili ka shqyrtuar çështjen penale në ngarkim të këtij personi dhe dy të tjerëve, akuzuar për veprën penale “Vjedhje me dhunë” në bashkëpunim, dhe “Vjedhje me pasojë vdekjen”. Çështja lidhet me dy incidente të ndodhur në Greqi përkatësisht më 1.04.2002 dhe 18.04.2002, si pasojë e të cilëve njëri prej viktimave, person me aftësi të kufizuara, është vjedhur dhe plagosur në faqe, ndërsa tjetri një shtetas gjerman, ka ndërruar jetë në banesën e tij<sup>44</sup>. Dy të pandehurit e tjerë, edhe ata shtetas shqiptarë, janë dënuar në Greqi. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat, ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*\*}/2016 për të pandehurin M.. Në përfundim të gjyqimit, Prokuroria ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit për të dyja veprat penale të mësipërme, kryer në bashkëpunim dhe dënimin me 17 vjet burgim. Me shumicë votash – subjekti dhe një anëtar tjetër i trupit gjykues [P. Z.] – kanë shpallur të pandehurin fajtor dhe dënuar me 17

<sup>43</sup> Raporti i DSIK-së konkludon për papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin, duke referuar edhe që: “[...] Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucioni i verifikimit, [...] rezultoi se gjatë periudhës në të cilën z. Hasa ushtronte detyrën si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, dyshohet të jetë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës, në formën e veprimeve korruptive, si dhe në formën e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm me qëllim lehtësimin e pozitës së të dënuarit/pandehurit. Gjithashtu institucionet verifikuese kanë ndarë informacion me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokurorinë për Krimet e Rënda [...] Durim Hasa ka shprehur gatishmërinë për të "ndihmuar, favorizuar" një të pandehur. Në përfundim, Grupi i Punës konfirmon konstatimin fillestar për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Durim Hasa ”.

<sup>44</sup> Shih paragrafin 9.1. të vendimit të Komisionit.

vjet burg për incidentin e dytë, atë të datës 18.04.2002 [vjedhje me pasojë vdekjen në bashkëpunim] dhe shpallur atë të pafajshëm për incidentin e parë, [vjedhjen me dhunë në bashkëpunim]. Shumica ka arsyetuar se për të pandehurin nuk janë kryer hetime për këtë incident, sikurse edhe që gjykimi është pezulluar edhe për dy të pandehurit e tjerë e nuk është ngritur as akuzë. Anëtarja në pakicë [R. P.] ka vlerësuar se çështja për incidentin e vjedhjes me plagosje nuk duhet të ishte përfunduar me pafajësi pasi pengon hetimin në të ardhmen nëse do të ketë ndryshime/zhvillime për këtë procedim nga vendime të mundshme penale në Greqi.

**17.11.** Më tej, me shumicë votash, trupi gjykues ka rrëzuar kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar. Shumica është mbështetur në dispozitën e paragrafit të dytë të nenit 403<sup>45</sup> të Kodit të Procedurës Penale në fuqi, që ndalon gjykimin e shkurtuar për vepra për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm. Subjekti ka votuar në pakicë që të pranojë kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar dhe arsyetuar se ndryshimet procedurale që ndalonin gjykimin e shkurtuar – dhe shkurtimin e gjykimit me 1/3 – të cilat kanë hyrë në fuqi në vitin 2017, nuk gjejnë zbatim për gjykimin në fjalë dhe ligji më i favorshëm duhet të gjejë zbatim. Duke zbatuar dispozitat materiale për zbatimin e ligjit më të favorshëm penal edhe në rastin e normave procedurale, në arsyetimin e tij në pakicë, subjekti ka shprehur se i pandehuri duhet të përfitonte nga zbritja e dënimit që pasjell gjykimi i shkurtuar pasi ligji duhet të shihet në mënyrë harmonike dhe meqenëse incidenti ka ndodhur në vitin 2002, kjo normë e re procedurale nuk duhet të zbatohet.

**17.12.** Gjatë hetimit administrativ, duke marrë shkas nga informacioni i përcjellë nga organet ligjzbatuese, Komisioni e ka pyetur subjektin për të dhënë shpjegime qoftë për të arsyetuar më tej vendimet e marra prej tij për këtë të pandehur, ashtu edhe nëse është takuar me dy individë të caktuar. Subjekti ka pohuar se njëri prej dy personave është i afërm i të pandehurit dhe që janë takuar gjatë kohës kur shqyrtohej çështja. Ai po ashtu ka pretenduar se njiheshin si banorë të të njëjtit qytet [Çorovodë] dhe fqinjë deri në vitin 2008. Takimi në fjalë është kryer me kërkesën e këtij individi dhe subjekti pretendon se ka mësuar lidhjen familjare me të pandehurin M. vetëm pasi janë takuar. Sipas subjektit, ai i ka shpjeguar z. M./xhaxhait të të pandehurit se gjykimi ishte i drejtë, dhe që nëse kërkonte të njihet me dosjen duhet të pyeste avokatin e nipit të tij, i cili posedonte të gjitha aktet. Personi tjetër është kushëri i tij i parë dhe subjekti ka mohuar që ai të jetë përpjekur të ndikojë<sup>46</sup>. Përfundimisht, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka treguar një sjellje të padenjë për një magjistrat duke qenë se ka takuar një të afërm të të pandehurit ndërsa shqyrtonte çështjen e tij, që përbën cenim të figurës dhe integritetit të gjyqtarit e ndikon në perceptimin e publikut për dhënien e drejtësisë. Nga ana tjetër, Komisioni nuk rezulton ta ketë përfshirë në vlerësimin e kryer për favorizimin e këtij të pandehuri, interpretimin e subjektit për fuqinë prapavepruese të normave procedurale penale.

<sup>45</sup> Kjo dispozitë parashikon që: “[2. ] Nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm”.

<sup>46</sup> Referuar vendimit objekt ankimi, subjekti ka shpjeguar se personi tjetër, G. Ç., është kushëriri i tij i parë. Ai nuk është përpjekur të ndikojë dhe i vetmi fakt që mban mend është se në një rast i ka treguar se prindërit e të pandehurit kishin nxjerrë në shitje shtëpinë në Poliçan për të liruar djalin nga burgju. Subjekti e ka këshilluar të mos përzihej me këtë çështje. Më pas e ka takuar rrallë e nuk kanë pasur asnjë bisedë për këtë temë.

**17.13.** Pasi analizoi nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim aktet në fashikull, me fokus faktet e përmbledhura më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Në kushtet që subjekti e ka konfirmuar takimin me dy persona për efekt dhe përpara vendimmarrjes përfundimtare për këtë të pandehur në vitin 2019, sikurse Komisioni, edhe trupi gjykues i Kolegjit konstaton se përputhen indiciet nga organet ligjzbatuese me faktet e rezultuara gjatë hetimit. Po ashtu, më së paku për sa i përket interpretimi që ka tentuar subjekti për të shkuar drejt gjykimit të shkurtuar, ndonëse në mënyrë të shprehur i ndaluar në veprat penale në fjalë, subjekti duket të ketë treguar qasje favorizuese ndaj të pandehurit në kushtet që nëse ai interpretim do të kishte shumicë votash, i pandehuri do të përfitonte zbritjen e 1/3 së dënimit. Ndërsa është e pamundur të provohet versioni i fakteve i potencuar nga subjekti, se personi tjetër, z. Ç. nuk u përpoq të ndikonte mbi vendimmarrjen, fakti i takimit të ndodhur e pranuar, u analizua nga trupi gjykues si tregues i saktësisë së indicieve në informacionin e organeve ligjzbatuese. Në përfundim, këto dy takime sikurse edhe mënyra sesi subjekti ka tentuar të zbusë dënimin e të pandehurit M., duke kryer një interpretim të zgjeruar me parime të ligjit material në një kontekst ligjor procedural dhe në kushtet që ky lehtësim përjashtohet shprehimisht nga ligji për rrethanat ligjore konkrete [neni 403/2 i Kodit të Procedurës Penale], u vlerësuan si qëndrime të subjektit që tregojnë qasje profesionale që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe pritshmëritë për paanësi dhe objektivitet në dhënien e drejtësisë që pritet prej një magjistrati.

#### *Çështja gjyqësore që i përket të pandehurit B. I.*

**17.14.** Së pari, si kontekst i përgjithshëm, nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se i pandehuri në fjalë dyshohet për vjedhjen e naftës në bashkëpunim me një person tjetër, R. B.<sup>47</sup>, në shoqëritë e angazhuara në ndërtimin e gazsjellësit TAP. Ndaj dy të pandehurve, me vendimin e datës 28.06.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, subjekti ka caktuar arrestin në burg. Pasi i dyshuari I. ka pranuar kryerjen e veprës penale në më shumë se një rast dhe në sasi të vogla, me mjete e në kohë të ndryshme, Prokuroria ka vendosur ta marrë të pandehur atë për vjedhjen në 23 korrik 2018, për vjedhje. Tre ditë më pas, në 26 korrik 2018, në cilësinë e gjyqtarit paraprak, subjekti ka zëvendësuar masën e sigurimit nga arrest në burg në detyrim paraqitjeje, me arsyetim që bazohet mbi ndryshimin e nevojave të sigurimit [për të pandehurin B. I.], pas komunikimit të akuzës, papërshtatshmërinë e masës së caktuar më parë për vjedhjen në bashkëpunim, faktin që dënimi i parashikuar për këtë vepër është më i ulët, dhe mbi rrezikshmërinë e ulët shoqërore, meqenëse i pandehuri është i padënuar më parë, dhe për të nuk ekzistojnë kushtet e arratisjes, kryerjes së një krimi tjetër apo edhe manipulimit të provave.

**17.15.** Vendimi i subjektit është ndryshuar nga Gjykata e Apelit, pas ankimit të Prokurorit. Kjo gjykatë shprehet se vendimi i shkallës së parë [i subjektit] është marrë në vlerësim të gabuar të provave dhe ligjit pasi fakti penal nuk ka pësuar *asnjë ndryshim* përpara dhe pas caktimit të masës.

---

<sup>47</sup> Ky i fundit është kapur në flagrancë në posedim të gazoil/naftë pa dokument në automjetin që drejtonte. I ndaluari ka pohuar se ai e ka blerë naftën nga B. I. Pas ushtrimit të kontrollit në banesën e këtij të fundit, u sekuestruan 8 enë plastikë 28.5 litërshe, 5 prej të cilave ishin mbushur me gazoil. Në këto kushte është kryer arrestimi në flagrancë për të dy personat, të cilët janë hetuar për dyshimin që në bashkëpunim me njeri - tjetrin kanë vjedhur naftë në kompanitë që merren me ndërtimin e gazsjellësit TAP për kryerjen e veprës penale të vjedhjes në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134, paragrafi 2 i Kodit Penal.

Përkundrazi, me pranimin e fajit nga i pandehuri, ka rrethana rënduese si përsëritja e bashkëpunimi. Gjykata e Apelit Vlorë ka urdhëruar vijimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Në vijim, me vendimin nr. 315, datë 13.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, të pandehurit B. I.<sup>48</sup> dhe R. B.<sup>49</sup> janë deklaruar fajtorë dhe janë dënuar me nga katër muaj burg secili.

**17.16.** Nga informacioni i dërguar Komisionit<sup>50</sup>, rezulton se Prokuroria për Krime të Rënda ka regjistruar një procedim penal në datën 25.09.2019, regjistruar me nr. {\*\*\*}/2019 në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për një sërë veprash penale. Në këtë procedim, ndër të tjerë, përmendet edhe emri i subjektit të rivlerësimit në kuadër të hetimit për vepra penale që lidhen me veprime korruptive të kryera nga funksionarë të drejtësisë.<sup>51</sup> Sipas materialit referues, Njësia Hetimore Qendrore “Për Krimin Ekonomik e Financiar” në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka rënë në dijeni të informacionit për një rast të dyshuar korrupsioni nga subjekti dhe një prokuror, dhe ndikimin e paligjshëm të ushtruar nga një avokat me qëllim favorizimin e të pandehurit I., kundrejt përfitimit financiar. Subjekti dyshohet të ketë sugjeruar që fajin ta merrte përsipër një tjetër person/vëllai i të dyshuarit. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në datën 07.01.2021, ka vendosur pushimin e procedimit penal në fjalë pasi nuk provohet se fakti ekziston. Sipas këtij vendimi nga hetimet e kryera nuk u provuan të dhënat e referuara në informacionin për të cilën është regjistruar procedimi penal.

**17.17.** Në përfundim të sa më sipër dhe pasi ka administruar edhe shpjegimet e subjektit, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka favorizuar të pandehurin duke i zëvendësuar masën e sigurimit, në kundërshtim me kriteret e ligjit. I pandehuri ka pasur rrethana rënduese, sikurse përsëritja, dhe subjekti ka dështuar të provojë përse rrethanat kishin ndryshuar, e pasjellë nevojën për ndryshimin e masës së sigurisë. Duke vlerësuar këto aspekte dhe informacionin nga organet ligjzbatuese, Komisioni ka konstatuar se me favorizimin e të pandehurit, subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

**17.18.** Pasi analizoi nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim aktet në fashikull, me fokus faktet e përmbledhura më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Zëvendësimi i masës së sigurimit pak ditë pasi i dyshuari ka marrë cilësinë e të pandehurit dhe ka pranuar kryerjen e veprës penale në mënyrë të përsëritur, edhe në analizën e kryer nga trupi

---

<sup>48</sup> Dënuar për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134, paragrafi 1 i Kodit Penal.

<sup>49</sup> Dënuar për veprën penale “Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, parashikuar nga neni 287/b, paragrafi 1 i Kodit Penal.

<sup>50</sup> Shkresë nr. {\*\*\*}, datë 30.04.2021, bashkëlidhur CD që përmban materiale të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2019, dërguar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

<sup>51</sup> Veprat penale për të cilat është regjistruar procedimi penal janë ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike dhe korrupsion pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, parashikuar përkatësisht nga nenet 245/1, 319/ç të Kodit Penal për veprime të kryera nga subjekti dhe ish-prokurori A. H., si dhe për ndikimin e paligjshëm prej avokatit A. M., i cili dyshohet se ka ushtruar ndikim ndaj subjektit dhe prokurorit H., me qëllim lirim nga burgu të të pandehurit B. I., kundrejt mitës. Në qershor të vitit 2018, vëllezërit B. dhe H. I., janë arrestuar në flagrancë për vjedhjen e naftës, dhe posedimin e canabis sattiva. Dyshohet se gjatë një takimi ndërmjet A. M. (avokati) dhe subjektit, ky i fundit e ka këshilluar që njëri nga vëllezërit të marrë përsipër fajin, me qëllim lirim nga vëllai tjetër. Gjithashtu dyshohet se avokati ka marrë një shumë prej 150.000 lekësh nga vëllai i të arrestuarve, R. I., shumë të cilën indikohet se ua ka dhënë shtetasve Durim Hasa dhe A. H., kundrejt lirit të shtetasit B. I..

gjykues i Kolegjit duket të përbëjë një qëndrim favorizues të subjektit, që përkon me indiciet që rezultojnë nga informacioni i përcjellë nga organet ligjzbatuese. Në kushtet që, sikurse ka konstatuar Gjykata e Apelit me ndryshimin e vendimit në fjalë, nuk ka rrethana që tregojnë nevojën për zbutje të masës apo ndryshim të faktit penal, është e pamundur të mos bëhet evident qëndrimi favorizues i dyshuar i subjektit për këtë të pandehur. Nëse shtohet edhe fakti që një muaj më herët subjekti kishte disponuar për arrestin në burg për të njëjtat fakte dhe mbi bazën e më pak të dhënave – në mungesë të pranimi të fajit nga i dyshuari – është e pakuptimtë e alogjike përse subjekti ka arsyetuar ndryshimin e kushteve në drejtim të lehtësimit të përgjegjësisë penale të të pandehurit, e jo në kahun e kundërt. Për sa më sipër, vendimmarrja e subjektit në mungesë të kriterëve për zëvendësimin e saj me një tjetër më të butë, të përcaktuara nga pika 2 e nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale<sup>52</sup>, krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar të pandehurin, ndonëse rrethanat tregojnë që kanë peshë rënduese në vlerësimin e masës së sigurimit personal.

17.19. Sa është shtjelluar më sipër, lidhur me marrëdhënien e miqësisë që subjekti ka pranuar me një person për të cilin ai ka gjykuar dy masa sigurie personale [z. L.] e më pas i ka kërkuar një deklaratë noteriale gjatë kontrollit që ushtrohej për të si subjekt deklarues nga ILDKPKI-ja, parë në tërësi me takimet e tij me individë që objektiv kishin biseda për çështjen, rezultojnë aspekte të ndryshme të veprimtarisë së subjektit në ushtrimin e detyrës, të cilat nuk mund të mos kenë efekt negativ në besimin e besimit të publikut te drejtësia. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që në komunitete jo të mëdha si ato që mbulojnë gjykatat ku subjekti ka ushtruar detyrën – Skrapar dhe më pas Berat – në perceptimin e publikut, shqyrtimi i çështjeve në ngarkim të palëve me të cilët ka marrëdhënie miqësore apo takimi me të afërm të të pandehurve, ka një peshë më domethënëse e kërkon një qasje veçanërisht të distancuar nga magjistratët<sup>53</sup>, edhe nëse pranohet versioni i fakteve sipas shpjegimit të subjektit. Nga ana tjetër, nëse të gjitha këto rrethana shihen në harmoni me ato që i janë referuar Strukturës së Posaçme Anti-Korrupsion, dhe sa rezulton nga indiciet e organeve ligjzbatuese, të cilat u konfirmuan nga hetimi administrativ i Komisionit dhe gjatë kontrollit të tij në Kolegj, u vlerësua që subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, dhe gjen vend zbatimi i parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, pavarësisht sa konstatuar në paragrafin 15.8. të vendimit, për procedimin penal në ngarkim të A. Z., Komisioni nuk rezulton ta ketë ngarkuar subjektin me ndonjë pasojë në vlerësimin tërësor. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të panevojshme të ndalet në vijim në shkaqet e ankimit apo në një analizë të arsyetimit të Komisionit për këtë çështje, duke konstatuar vetëm që shpjegimet e subjektit rezultuan bindëse e të bazuara në ligj.

<sup>52</sup> “[2. ] Kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë. [...]”.

<sup>53</sup> Ndër të tjerë, referuar Rregulli 4.2. dhe paragrafit 114 të Komentarit të Parimeve të Bangalores për Sjelljen e Gjyqtarëve: “Një gjyqtar/e duhet të përgatitet të jetë objekt i kontrollit e vëzhgimit të përhershëm e komenteve publike dhe për pasojë, të pranojë kufizime të aktiviteteve të tij/saj që mund t’i duken barrë një qytetari të zakonshëm. Gjyqtari/ja duhet ta bëjë këtë me vullnet të lirë dhe më dëshirë edhe kur këto veprime nuk do të shiheshin negativisht nëse kryhen nga anëtarë të tjerë të komunitetit apo të profesionit. Ky parim gjen zbatim qoftë në jetën profesionale, ashtu edhe në sjelljen personale të gjyqtarit/es. Ligjshmëria e sjelljes së gjyqtarit/es ndonëse me rëndësi, nuk përbën të vetmen njësi matëse të sjelljes së përshtatshme”.



18. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Durim Hasa gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 399, datë 14.06.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 399, datë 14.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Durim Hasa.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 05.11.2024.

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*